

**ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM
NË POLITIKAT ZHVILLIMORE
DHE PËRFSHIRJA E
AKADEMISË**

Nëntor 2020

AUTOR:
BALKAN GREEN FOUNDATION

PUBLIKIMI:
NËNTOR 2020

DIZAJNI DHE RRADHITJA:
TOMATO STUDIO

Botim i Balkan Green Foundation (BGF). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit “Promovimi i Energjisë së Gjelbër në Kosovë” i mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Pikëpamjet e hartuesit të këtij dokumenti si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

Implemented by

**balkan
green
foundation**

Supported by



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të analizojë përfshirjen e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm në dokumentet e politikave zhvillimore të Kosovës, si dhe komponentën e përfshirjes së edukimit dhe hulumtimit shkencor në të ardhmen e qëndrueshme të vendit. Pyetja kryesore hulumtuese është se sa është i përfshirë koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm dhe shkencës së qëndrueshmërisë në dokumentet strategjike zhvillimore të vendit.

Hulumtimi është realizuar përmes metodës së analizës teorike të dokumentave strategjike dhe rregullative të vendit, si dhe intervistave me akterët përgjegjës për zbatimin e tyre. Janë analizuar nga aspekti teorik gjithsej 15 dokumente strategjike duke u nisur nga ato që skadojnë sivjet e deri te më e largëta që skadon në vitin 2036. Hulumtimi i ka analizuar këto dokumente për të parë se sa e kanë përfshirë zhvillimin e qëndrueshëm në kapitujt e tyre përmbajtësor si: misioni, vizioni, qëllimi dhe objektiva, masat, prioritetet dhe parimet. Gjithashtu, është analizuar edhe se sa është përfshirë edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm dhe hulumtimi shkencor në këto dokumente zhvillimore. Përveç analizës teorike janë konsultuar edhe përfshirja e akademisë dhe e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e këtyre dokumentave nga institucionet bartëse. Për këtë janë intervistuar katër përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për zbatim të dokumentave strategjike, një përfaqësues i shoqërisë civile dhe pesë përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë.

Nga hulumtimi del se nuk ekziston një strategji për zhvillimin e qëndrueshëm dhe se asnjë nga dokumentet strategjike nuk e përmban këtë koncept në titullin e saj. Disa nga strategjitë dhe planet e veprimit të analizuar e përmbajnë konceptin që nga qëllimi dhe misionin i tyre e deri te masat e caktuara për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, është evidente një mungesë konsistence dhe kontinuiteti të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm nëpër kapitujt përmbajtësor, si dhe e zërthimit të tij prej qëllimit e deri te masat konkrete për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm. Mungojnë edhe raportet se sa janë zbatuar strategjitë, sidomos ato më afatgjata. Nga hulumtimi shihet se institucionet akademike në mënyrë shumë sipërfaqësore kanë qenë të angazhuara në zhvillimin e dokumenteve strategjike që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm. Pavarësisht se universitetet e prodhojnë dijen në Kosovë, ato ende nuk shihen si akterë të fuqishëm të zhvillimeve që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	1
2. Përkufizimet për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë	4
3. Baza ligjore për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë	5
4. Metodologjia e hulumtimit	7
5. Rezultatet e hulumtimit	9
5.1. Zhvillimi i qëndrueshëm në qëllime dhe synime	9
5.2. Zhvillimi i qëndrueshëm si mision	11
5.3. Vizioni për zhvillim të qëndrueshëm	12
5.4. Zhvillimi i qëndrueshëm në objektiva	14
5.5. Masat për zhvillim të qëndrueshëm	17
5.6. Zhvillimi i qëndrueshëm si prioritet	21
5.7. Zhvillimi i qëndrueshëm në parime	23
6. Përfshirja e akademisë në zhvillimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike	25
7. Konkluzionet e dokumenteve strategjike	28
8. Politikat zhvillimore dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	30
8.1. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	31
8.2. Zhvillimi i qëndrueshëm në KKK	35
8.3. Shkenca e qëndrueshmërisë	37
9. Përfundimet	40
10. Shtojcat	42

AKRONIMET

BE	Bashkimi Evropian
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
GHG	Greenhouse gases (Gazrat me efekt serrë)
EE	Eficienca e Energjisë
FBV	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
FA	Fakulteti i Arkitekturës
FIEM	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
FIM	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
FKEE	Fondi Kosovar për Eficiencë të Energjisë
FShJM	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
FSHMN	Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore
FEdu	Fakulteti i Edukimit
INDEP	Instituti për Politika Zhvillimore
JICA	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
KKK	Korniza Kurrikulare e Kosovës
LMM	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
MPBAP	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MDG	Millennium Development Goals/(Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit)
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
PHK	Plani Hapësinor i Kosovës 2010-20+
QEQ	Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri
PKEK	Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
PKVBRE	Plani Kombëtar për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë 2011-20
PVKEE	Plani i Veprimit të Kosovës për Eficiencën e Energjisë 2010-18
SPVB	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020
SERK	Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021

SKPVNK	Strategjia e Kosovës dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2019-2028
SMM	Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022
SMRK	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025
SRKMM	Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022
SSHUK	Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës 2017-2036
SVL	Strategjia për Vetqeverisjen Lokale 2016-2026
SZHEL	Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2019-2023
SZHP	Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
UP	Universiteti i Prishtinës
ZKM	Zyra e Kryeministrit

1 Hyrje

HERMAN DALY JEP TRI KUSHTE PËR NJË SHOQËRI TË QËNDRUESHME:

- (1) Normat e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme nuk duhet të tejkalojnë vlerat e rigjenerimit të tyre;
- (2) Normat e shfrytëzimit të burimeve jo të ripërtëritshme nuk duhet të kalojnë normën në të cilën ato zëvendësohen nga burime të ripërtëritshme;
- (3) Normat e emetimit të ndotjes nuk duhet të tejkalojnë kapacitetin asimilues të mjedisit.

Historikisht, krijuesi aktual i konceptit klasik të qëndrueshmërisë dhe projektuesi i konceptit modern të qëndrueshmërisë është Hans Carl von Carlowitz. Më 1713, Carlowitz, një inxhinier dhe menaxher pyjesh, botoi librin e tij "Sylvicultura oeconomica oder Anweisung zur wilden Baumzucht - Ekonomi ekologjike ose udhëzim për ngritjen e pyjeve të egra", duke kritikuar mbishfrytëzimin dhe shkatërrimin e pyjeve, dhe duke propozuar parimin "që druri duhet të përdoret me kujdes". Carlowitz sugjeron se "njeriu nuk duhet të veprojë kundër natyrës", por ta ndjekë atë dhe të menaxhojë resurset me kujdes duke formuar parimet socio-etike themelore: të gjithë kanë pretendim për ushqim dhe mjete jetese (koncepti i nevojave në përkufizimin e mëvonshëm), duke përfshirë "nënshitetasit e varfër" (koncepti i barazisë) si edhe "pasardhësit e dashur", me fjalë të tjera, brezat e ardhshëm.¹

Përkufizimi më i zakonshëm i zhvillimit të qëndrueshëm në terminologjinë e sotme (i njohur shpesh edhe si përkufizimi Brundtland) gjendet në raportin "E ardhmja jonë e përbashkët" të vitit 1987 dhe thotë se: "zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi që plotëson nevojat e gjeneratave të tashme, pa komprometuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre".²

Çfarë saktësisht do të thotë shprehja "i qëndrueshëm"? Oxford English Dictionary në edicionin e vitit 1961 e gjetur kuptimin e kësaj shprehjeje që nga mesjeta. Nga përkufizimet e shumta të gjetura, një i tillë jep kuptimin që duket më relevant për përkufizimin e ai është: "të vazhdojë të jetë", me fjalë të tjera për të ruajtur ekzistencën e diçkaje në gjendjen si është. Përkufizimi tjetër është "të shkaktojë vazhdimin e një gjendjeje të caktuar" dhe përkufizimi tjetër "për ta mbajtur ose ruajtur në nivelin ose standardin e duhur" dhe më në fund, "për të ruajtur gjendjen". Kështu,

zhvillimi i qëndrueshëm duhet të jetë në gjendje "të ruajë" ose "të mbajë një ngarkesë". Fjala qëndrueshmëri rrjedh nga fjala latine *sustinere*, të cilën fjalorë të ndryshëm latinisht-anglisht e përkthejnë si "mbështetje, mbajtje ose kthim prapa". Në përgjithësi shprehja "i qëndrueshëm" në gjuhë të ndryshme nënkupton dhe gjithmonë ka nënkuptuar struktura që mund të çojnë, respektivisht mund ta mbajnë një ngarkesë.³ Kjo është konstanta thelbësore në strukturën e kësaj shprehjeje.⁴


Përkufizimi i Brundtlandit përmban brenda tij dy koncepte kryesore. I pari është koncepti i "nevojave", me theks në nevojat thelbësore të të varfërve në botë, të cilave duhet t'u jepet përparësi kryesore. Por cilat janë ato nevoja, dhe a janë të gjithë njësoj të rëndësishme? Fjalorët mjekësorë si nevoja themelore të njeriut përkufizojnë "elementet e nevojshme për mbijetesën dhe shëndetin normal mendor dhe fizik, të tilla si ushqimi, uji, strehimi, mbrojtja nga kërcënimet mjedisore dhe dashuria".⁵



Në vitin 1943, Abraham Maslow⁶ propozoi pesë lloje të ndryshme të nevojave njerëzore në formën e një hierarkie (Hierarkia e nevojave e Maslow-it), duke filluar me më themeloren:

mbijetesën. Nevojat fiziologjike si ushqimi dhe streha, pasohen nga nevojat që lidhen me sigurinë. Nevoja e tretë është nevoja për dashuri dhe përkatësi. Së katërti, njerëzit kanë nevojë për respekt, si edhe nevojë për t'u respektuar. Nevoja përfundimtare në hierarki është nevoja për vetë-aktualizim⁷ (përbushja e potencialit). Hierarkia sugjeron që nevojat themelore duhet të plotësohen para nevojave më pak themelore; p.sh. një person i uritur do të kërkojë të plotësojë nevojat për ushqim para vetë-aktualizimit.

A është e njëjtë nevoja e një personi të pasur për një kompjuter të gjeneratës së fundit sa nevoja e një personi të varfër për ujë të



1. Carlowitz, H. C. von ([1713] 2013). *Sylvicultura oeconomica*. München: Oekom Verlag.

2. World Commission on Environment and Development, *Our Common Future* (London: Oxford University Press, 1987).

3. *The Oxford English Dictionary (1961 Printing)* : Volume 10, T-U James A. H. Et Al. Murray

4. *Theories of Sustainable Development*, edited by Judith C. Enders, and Moritz Remig, Routledge, 2014.

5. <https://medical-dictionary.thefreedictionary.com/basic+human+needs>

6. Maslow, A.H. (1943). *A theory of human motivation*. *Psychological Review*, 50, 370–396.

7. <https://www.chegg.com/homework-help/definitions/maslows-hierarchy-of-needs-13>

pastër? Raporti i Brundtlandit ka një qëndrim të qartë sa u përket nevojave themelore ku nevojat si: veshmbathja, ushqimi, strehimi, energjia dhe puna kanë përparësi. Megjithatë, edhe nëse nevojat tona themelore janë përmbushur, mund të na mungojë edukimi, mjetet e komunikimit etc., përderisa hendeku ndërmjet të pasurve dhe të varfërve në këto çështje shpesh është shumë i gjerë.

Pjesa e dytë e përkufizimit të Brundtlandit prek konceptin e “gjeneratave”. Po çka në realitet paraqet një gjeneratë? Gjenerata njerëzore paraqet “një grup njerëzish të lindur afërsisht në të njëjtën kohë dhe të rritur në të njëjtin vend dhe që konsiderohen të kenë të njëjtat përvoja ose qëndrime”. Përkufizimi tjetër është se “gjenerata është periudha kohore, zakonisht e konsideruar të jetë rreth 30 vjet, që nevojitet që fëmijët të rriten dhe të bëhen të rritur për të pasur fëmijët e tyre”.⁸ Njerëzit e gjeneratës së njëjtë shfaqin karakteristika, preferenca dhe vlera të ngjashme gjatë jetës së tyre, si p.sh. karshi blerjeve, veshjes, komunikimit, përdorimit të teknologjisë, etj. Teknologjia bëhet qendrore për dy arsye. Së pari, përparimet teknologjike, bashkë me rritjen e popullsisë, kanë rezultuar në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore për të rrezikuar seriozisht mirëqenien e gjeneratave të ardhshme. Së dyti, kufijtë e imponuar nga natyra janë prekur nga teknologjia tashmë në masë bukur të madhe. Në një vend ku druri është i vetmi material ndërtimor, ruajtja e pyjeve bëhet shumë më e rëndësishme se në një tjetër ku ndërtesat ndërtohen nga guri dhe çimentoja. Zëvendësimi i materialeve të ndërtimit ose materialeve në përgjithësi është një çështje kyçe e zhvillimit të qëndrueshëm.

GJASHTË UDHËZIMET E PËRGJITHSHME PËR RISTRUKTURIMIN E BOTËS DREJT QËNDRUESHMËRISË SIPAS DONNELLA MEADOWS:

- (1) Minimizoni përdorimin e burimeve jo të ripërtëritshme;
- (2) Parandaloni erozionin e burimeve të ripërtëritshme;
- (3) Përdorni të gjitha burimet me efikasitet maksimal;
- (4) Ngadalësoni dhe përfundimisht ndaloni rritjen eksponenciale të popullsisë dhe kapitalit fizik;
- (5) Monitoroni gjendjen e burimeve, mjedisin natyror dhe mirëqenien e njerëzve;
- (6) Përmirësoni kohën e reagimit ndaj stresit mjedisor.

2. Përkufizimet për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë

Republika e Kosovës është shteti më i ri në Evropë dhe zhvillimin e legjislativitetit aktual e ka filluar në vitin 2002 me themelimin e institucioneve të para të përkohshme të vetëqeverisjes pas zgjedhjeve. Këtij legjislativiteti i ka paraprirë komiza rregullative e UNMIK-ut të njohura si rregullore.

Në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit - LMM (nr. 03/L-025), zhvillimi i qëndrueshëm përkufizohet si “harmonizimi i zhvillimit ekonomik dhe mbrojtja e mjedisit për të plotësuar nevojat e të sotmes pa rrezikuar mundësitë që edhe brezat e ardhshëm t’i shfrytëzojnë këto kapacitete dhe t’i përmbushin nevojat e veta”. Ndërsa më tej në PHK, zhvillimi i qëndrueshëm përkufizohet si “zhvillim social ekonomik dhe mjedisor i cili shfrytëzimin e resurseve e konsideron si pasuri e cila duhet të ruhet edhe për gjeneratat e ardhshme”. Në politikat zhvillimore të Kosovë, shumë shpesh flitet për ‘zhvillimin ekonomik’, ‘zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm’ dhe ‘zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik’. Por ku dallojnë këto?

Zhvillimi ekonomik në PHK definohet si “proces me të cilin krijohen të mira materiale, përmes mobilizimit human, financiar, kapitalit, resurseve fizike dhe natyrore, për të gjeneruar shërbime dhe të mira materiale atraktive/të ofrueshme për treg.” Ndërsa në tej zhvillimi i qëndrueshëm përkufizohet si “zhvillimet që plotësojnë nevojat e së tashmes duke mos komprometuar aftësitë e gjeneratave të ardhshme që të plotësojnë nevojat e tyre.” Kjo nënkupton se veprimet zhvillimore të së tashmes nuk guxojnë të shpenzojnë resurset të cilat nuk mund të përtërihen ose zëvendësohen (PHK).

Kuvendi i Kosovës më 25 janar 2018 ka miratuar rezolutën për OZHQ. Më 10 tetor 2018, themelohet Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm i udhëhequr nga Kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale (deri në fund të vitit 2019 është udhëhequr nga deputetja Besa Baftiu). Ky Këshillë do të funksionojë si një subjekt monitorues për të siguruar që të arrihet mbarëvajtja e zbatimit të OZHQ-ve. Anëtarët Këshillit do të jenë nga strukturat e brendshme të Kuvendit, si dhe nga institucione të jashtme.

Zhvillimi i qëndrueshëm në themelin e konceptit të vet e ka shfrytëzimin e resurseve. Resurset zhvillimore menaxhohen brenda konceptit të kufizimeve të tyre dhe ato: janë të shterrshme dhe nuk janë të shpërndara njësoj. Sipas nenit 4 të LMM-së, shfrytëzimi i qëndrueshëm nënkupton “shfrytëzimin e resurseve natyrore që sigurojnë plotësimin e nevojave të sotme, pa cenuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto resurse.”

8. <https://www.collinsdictionary.com/us/dictionary/english/generation>

3. Baza ligjore për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë

Baza ligjore për zhvillim të qëndrueshëm gjendet në vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku në Kapitullin 9 (Marrëdhëniet ekonomike) thuhet se “Republika e Kosovës promovon mirëqenien për të gjithë qytetarët duke inkurajuar një zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik” (neni 119, f. 4).⁹ Më tutje, disa nga ligjet respektive e përfshijnë në dispozitat hyrëse (qëllimi dhe fusha e rregullimit) dhe në parimet udhëheqëse. Kështu, LMM-ja si qëllim të tij ka harmonizimin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm (neni 1), si dhe sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të ZHQ-së (neni 2). Sipas nenit 2 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (03/L-233), qëllimi i ligjit është që të rregullojë mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj. Qëllimi i Ligjit për Ujëra (04-L/147) është që “të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social-ekonomik (neni 1, f.2).”

Në preambulën e vet, Ligji për Planifikimin Hapësinor (2003/14) vendos edhe qëllimin e “arritjes së drejtpeshimit midis zhvillimit dhe ruajtjes së hapsirave të hapura, të gjelbëruara dhe mbrojtjes së mjedisit”. Ligji për Pyjet e Kosovës si qëllim vendos “krijimin e bazës ligjore për pyejt si resurse kombëtare, dhe për administrimin, mbrojtjen, ruajtjen, shtimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor të Kosovës.”

Ligji për Tokën Bujqësore (02/L-26) si fushë të rregullimit të vet përcakton “shfrytëzimin, mbrojtjen, rregullimin dhe qiradhënien e tokës bujqësore, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm” (neni1).

Ligji për Energjinë (05/L-081) në nenin 6 mbi Strategjinë e Energjisë, kërkon që ky dokument “të shfrytëzojë në mënyrë të arsyeshme burimet vendore të energjisë sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm” dhe “të promovojë investime në sektorin e energjisë në funksion të përdorimit të teknologjisë së pastër për shfrytëzim të linjtit, në funksion të mbrojtjes së mjedisit”.¹⁰

Edhe legjislacioni horizontal, më konkretisht Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (03/L-230) si qëllim të vetin ka që të “përcaktojë kushtet, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, përmes integritit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm” (neni 1, f. 2).¹¹ Shumica e ligjeve mjedisore e përmbajnë zhvillimin e qëndrueshëm si një nga parimet udhëheqëse të legjislacionit, por pa e elaboruar më tej në dispozitat e tyre.

9. Kushtetuta e Kosovës, Burimi: http://kuvendikosoves.org/common/docs/Kushtetuta_e_Republikes_se_Kosoves_me_amendamentet_I-XXV_2017.pdf Qasur me 23. 04. 2020

10. Ligji për energjinë Nr. 05/L -081/2026 Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12689>, qasur me 24. 04. 2020

11. Veselaj, Z. (2019). Principles of Sustainable Development as Norms of the Current Legislative Framework in 12. Kosovo. *European Journal of Sustainable Development Research*, 3(4), em0099.

<https://doi.org/10.29333/ejdsdr/5878>



4. Metodologjia e hulumtimit


Hulumtimi është realizuar me një metodë të përzier: analiza teorike e dokumenteve strategjike që prekin zhvillimin e qëndrueshëm dhe intervista me akterë nga institucionet qeveritare (sponzorues të këtyre dokumenteve), përfaqësues të institucioneve akademike dhe nga shoqëria civile. Analiza teorike është kryer duke analizuar se sa e përfshijnë këto dokumente në përmbajtjen dhe dispozitat e tyre konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm. Janë analizuar se në cilin nga komponentet e përfshijnë këtë koncept: qëllimet, misioni, vizioni, masat, aktivitetet, parimet dhe prioritetet. Gjithashtu, këto dokumente janë analizuar se sa e përfshijnë shkencën e qëndrueshmërisë dhe edukimin për zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë analizën e dokumentit kryesor kombëtar të edukimit që është Korniza Kurrikulare e Kosovës (KKK).

Pjesa e dytë e hulumtimit ka përfshirë intervista me përfaqësues të institucioneve sponzorizuese të dokumenteve strategjike, përfaqësues të institucioneve akademike dhe të shoqërisë civile mbi përfshirjen e tyre në hartimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike, si dhe perspektivat për të ardhmen. Një faktor kufizues në realizimin e komponentës së intervistave ka qenë se me fillimin e tyre, ndodhi izolimi nga pandemia Covid-19, kështu që është dashur që ato të realizohen në mënyrë virtuale ose edhe përmes dërgimit të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve përmes postës elektronike. Kjo ka rezultuar në numër të kufizuar të inpueteve nga ana e institucioneve, sidomos atyre qeveritare dhe të shoqërisë civile. Faktorë tjetër kufizues ishin edhe ndryshimet në qeveri gjatë vitit 2020 dhe rotacioni i disa dikastereve prej një ministrie në tjetrën, kjo vlen sidomos për mjedisin që brenda 6 muajsh së hulumtimit lëvizi nga ministri më vete (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) te Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit dhe në fund te Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ambientit ku është aktualisht.

Nga institucionet akademike, pyetjet e intervistës u janë dërguar tri institucioneve dhe gjashtë personave (profesorë), ndërsa përgjigje janë marrë kryesisht nga njësitë akademike dhe QEQ e UP-së, si dhe nga një fakultet i Universitetit të Prizrenit.

Përgjigja nga përfaqësuesit e shoqërisë civile ka qenë më e ulët. Nga katër OJQ-të e kontaktuar rreth punës tyre në zhvillimin e qëndrueshëm, vetëm INDEP-i dhe Fondacioni Jeshil janë përgjigjur në pyetjet e dërguara.

GRAF. 1 VALIDITETI I DOKUMENTEVE TË SHQYRTUARA NË HULUMTIM



5. Rezultatet e hulumtimit

Zhvillimi i qëndrueshëm në dokumentet e politikave sektorale adresohet në kuadër të kapitujve të ndryshëm përmbajtësorë. E përbashkëta e të gjithave është se asnjë nga dokumentat nuk e përmban në titull zhvillimin e qëndrueshëm pavarësisht që fusha e rregullimit të tyre e prek atë, ku më shumë e ku më pak. Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) në ballinën e saj ka të shkruar një fjali “plan për zhvillim të qëndrueshëm” por nuk sqarohet më tej se çka nënkupton sllogani i tillë: a është moto e dokumentit apo diçka tjetër sepse nuk është se elaborohet më thellë në brendi të dokumentit. Po të ishte moto, do të duhej të reflektohej në përmbajtjen e tij, gjë që nuk vërehet në dokument. Si term i përgjithësuar dhe pa adresim konkret është mjaft prezent në dokumente të ndryshme strategjike por edhe legjislativë. Zhvillimi i qëndrueshëm në dokumentet e politikave sektorale adresohet në kuadër të kapitujve të ndryshëm dhe ne do të trajtojmë përfshirjen e konceptit në: qëllime dhe synime, mision dhe vizion, objektiva dhe qëllime, si dhe masa e prioritete.

5.1. Zhvillimi i qëndrueshëm në qëllime dhe synime

Qëllimi në fjalorët bashkëkohorë përkufizohet si “caku ose fundi drejt të cilit është drejtuar një përpjekje e caktuar”.¹² Zhvillimin e qëndrueshëm si qëllim të vetin e adresojnë disa dokumente strategjike të Kosovës. Kështu, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (SPVB) si qëllim të dokumentit përcakton “zhvillimin e qëndrueshëm bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore”.¹³ Më tutje dokumenti thekson se indikatorët e strategjisë do të ndihmojnë në “përcaktimin dhe monitorimin e politikave kombëtare për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për raportimin për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM).”

Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës (SSHUK) si qëllim të vetin ka “të ofrojë një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm të sektorit të ujërave duke përmbushur nevojat e furnizimit me ujë të pijshëm, ujë për prodhimin e ushqimit, për ujitjen e tokave bujqësore, për industrinë, sport, rekreacion dhe gjenerimin e energjisë elektrike”.¹⁴ Qëllimi i përgjithshëm i SUSHK-së është që “të siguroj zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme

për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin socio-ekonomik të Republikës së Kosovës”. Të dyja dokumentet koncept kyç e kanë shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për plotësimin e nevojave të popullatës.

Strategjia e Energjisë së Kosovës (SERK) përcakton objektivat themelore të Qeverisë për zhvillimin e sektorit të energjisë duke marrë për bazë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ruajtjen e mjedisit, furnizimin e sigurt dhe cilësor të konsumatorëve, shfrytëzimin eficient të energjisë, zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese konvencionale dhe të ripërtëritshme, krijimin e tregut konkurrues, zhvillimin e sistemit të gazit natyror dhe krijimin e vendeve të reja të punës që ndërlidhen me sektorin e energjisë. SERK-ja u referohet qëllimeve strategjike të BE-së për sektorin energjetik: 20:20:20.¹⁵

Rekomandime:

Të përcillet me masa konkrete komponenti ishshfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe të ujit bazuar në synimet e planifikimit hapësinor

Të adresohet se si mund të arrihet Caku 20:20:20 kur resurset energjetike të përdorshme aktualisht janë pothuajse njëburimore.

Edhe pse nuk e ka përcaktuar si qëllim, Strategjia e Kosovës dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike (SKPVNK) paraqet një mundësi që të gjenden dhe përcaktohen masat për zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë (GHG) dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, komponenta të cilat do të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm. Strategjia parasheh “reagimin efektiv ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh parimet ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm”.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) ka qëllim që përmes tërheqjes së investimeve “të huaja të hapë vende të reja të punës dhe të rrisë të hyrat buxhetore dhe që zhvillimi i përgjithshëm ekonomik të ndihmojë në zhvillim të qëndrueshëm komunal”.

Synimi si përkufizim paraqet “një rezultat që planet ose veprimet e caktuara synojnë të arrijnë”¹⁶ PHK-ja si synim të vetin adreson “zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, të balancuar, të bazuar në resurse natyrore, njerëzore, teknologji moderne, konkurrencën e tregut dhe përmbushjes së standardeve për mbrojtjen e mjedisit”.¹⁷ Në dokumentet e tjera nuk janë gjetur synime të përkufizuara.

12. <https://www.merriam-webster.com/dictionary/goal>

13. Strategjia dhe plani për Biodiversitetin e Kosovës 2011-20 Burimi: [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_per_Biodiversitet\[1\].pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_per_Biodiversitet[1].pdf) Qasur me 23. 04. 2020

14. Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës 2017-2036, Burimi http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Shtetërore_e_Ujërave_shqip.pdf Qasur me 24. 04. 2020

15. Synimet e 20-20-20 të BE-së: rritja 20% në efikasitetin e energjisë, ulja 20% e emetimeve të CO2 dhe 20% energjie e rinovueshme deri në vitin 2020) Burimi: <https://esmig.eu/page/20-20-20-goals> Qasur me 19. 08.2020.

16. <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/aim>

17. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-20+ Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_Hapësinor_i_Kosoves_2010-2020_shqip.pdf Qasur me 10.04.2020

5.2. Zhvillimi i qëndrueshëm si mision

Deklaratat e misionit zakonisht përdoren nga organizatat dhe kompanitë dhe më rrallë në dokumentet strategjike. Deklarata e misionit sqaron në mënyrë të shkurtër dhe koncize arsyen pse ekziston organizata ose kompania.¹⁸ Misioni përkufizohet si “një deklaratë me shkrim e qëllimit dhe fokusit kryesor të një organizate që normalisht mbetet e pandryshuar me kalimin e kohës”. Deklaratat e misionit të hartuara siç duhet shërbejnë si filtra për të ndarë atë që është e rëndësishme nga ajo që nuk është, si dhe komunikojnë ndjenjën e drejtimin të synuar për të gjithë organizatën.¹⁹ Megjithatë, jo rrallë deklarata e misionit përkufizohet edhe në dokumentet strategjike. Nga dokumentet e analizuara, dy e përmendin zhvillimin e qëndrueshëm në deklaratën e misionit të tyre: ai i fushës së energjetikës dhe ai i minierave, që paraqesin dy nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Misioni i Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës (SERK) është “krijimi i kushteve për furnizim të besueshëm dhe të sigurtë me energji, për kërkesën në rritje për energji, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse, duke pasur në konsideratë diversifikimin e burimeve, përdorimin me efikasitet të energjisë, shfrytëzimin maksimal të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe mbrojtjen e mjedisit në të gjitha aktivitetet e sektorit”.²⁰

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (SMRK) në misionin e vet përmban formulimin për “krijimin e të gjitha kushteve ligjore dhe institucionale për rritjen e shpejtë të investimeve në sektorin minerar, forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e interesit të komunitetit dhe garantimin e qëndrueshmërisë mjedisore”.²¹

Nga hulumtimi del se koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm si mision është anashkaluar në shumicën e dokumentave dhe trajtohet në vetëm dy të tilla. Megjithatë, nëse këto dy dokumente strategjike zbatohen siç është shkruar, është pozitiv fakti se energjia dhe minierat janë faktorë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të vendit.

18. <https://www.investopedia.com/terms/m/missionstatement.asp>

19. <http://www.businessdictionary.com/definition/mission-statement.html>

20. *Strategjia Energjetike e Kosovës 2017-2026*,

Burimi: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energjiise_2017-26_-.pdf Qasur me 12. 04. 2020

21. *Strategjia Minerare e Kosovës 2012 -2025*,

Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Minierare_e_Republikes_se_Kosoves_2012-2025.pdf

Qasur me 12.04. 2020

5.3. Vizioni për zhvillim të qëndrueshëm

Sipas Oxford Dictionary, vizioni është “aftësia për të menduar ose planifikuar të ardhmen me imagjinatë”²², ndërsa Merriam Webster vizionin e përkufizon si “një mendim, koncept ose objekt i formuar nga imagjinata”.²³ Disa nga dokumentet e analizuar kanë deklaratë të vizionit dhe e përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm në të.

Në mënyrë që Kosovës t'i mundësohet një zhvillim i qëndrueshëm dhe arritje e standardeve më të larta të jetesës, Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (SKZH) kërkon rritje ekonomike vjetore prej mbi 3.3%.²⁴ Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës (SERK) në vizionin e saj së synon “krijimin e një sektori të zhvilluar të energjisë, të pa dëmshëm për mjedisin dhe shëndetin, në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenies shoqërore në Kosovë në kuadër të një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë”. Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM) si vizion të vetin e ka “mjedisin e pastër me një zhvillim të qëndrueshëm dhe të sigurt”.²⁵

Në vizionin e Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës (SMRK) qëndron vizioni për një “zhvillim të resurseve minerare dhe zgjerim e modernizim të industrisë së përpunimit minerar për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqenies për qytetarët”.

Rekomandime:

Deklaratat e vizionit të qëndrojnë si të tilla sepse shpesh më shumë përngajnë në objektiva.

Vizioni nuk duhet të duket utopi dhe duhet të jetë i arritshëm për një periudhë të arsyeshme kohore (rasti i SPVNMK-së).

22. <https://en.oxforddictionaries.com/definition/vision>

23. <https://www.merriam-webster.com/dictionary/vision>

24. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016- 2021*, Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf Qasur 27. 03. 2020

25. *Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022* Burimi: https://mmph.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Strategjia_e_Mbrojtjes_s%C3%AB_Mjedisit_-_2013_-2022_Shqip_748721.pdf Qasur 02. 04. 2020

Vizioni i Strategjisë së Kosovës dhe Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike (SKPVNK) është “Kosova me zero emitim të gazeve serrë, me aftësi për tu përshtatur me ndryshimet klimatike, që në mënyrë efektive zbut shkaqet nga ndryshimet klimatike, parashikon dhe i përgjigjet ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke marrë parasysh parimet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm”²⁶. Nga të gjitha dokumentet, SKPVNK-ja e ka vizionin më ambicioz (për të mos thënë të paarritshëm) për periudhën e vlefshmërisë dhe zbatimit të vet.

Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) në vizionin e vet për të ardhmen e përcakton Kosovën ndër të tjera si një “vend i integruar në BE, me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik” dhe “që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve”. Ndërsa Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) në vizion përcakton “krijimin e politikave për zhvillim ekonomik lokal për të siguruar një qëndrueshmëri të ekonomisë lokale, në mënyrë që të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në të gjitha fushat”.²⁷



5.4. Zhvillimi i qëndrueshëm në objektiva

Objektiva përkufizohet si “diçka që planifikoni të bëni ose të arrini”²⁸, por edhe si “një rezultat specifik që një person ose sistem synon të arrijë brenda një afati kohor dhe me burimet e disponueshme”. Në përgjithësi, objektivat janë më specifike dhe më të lehtë për t'u matur sesa qëllimet. Objektivat janë mjete bazë që i koordinojnë dhe organizojnë të gjitha planifikimet dhe aktivitetet strategjike. Ato shërbejnë si bazë për krijimin e politikave dhe vlerësimin e performancës.²⁹

Një ndër objektivat e Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM) është “shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, mbrojtja e biodiversitetit dhe peisazheve natyrore”. Ndërkaq një nga katër objektivat strategjike të Strategjisë Shtetërore të Ujërave të Kosovës (SSHUK) është “ruajtja dhe mbrojtja e ekosistemeve ujore (prurja e pranueshme ekologjike).

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës (SERK) në objektivat e veta strategjike e përcakton sektorin e energjisë si “njërën nga shtyllat më të rëndësishme të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit”. Zhvillim i përshtetshëm dhe i qëndrueshëm ekonomik për Kosovën do të varet në masë të konsiderueshme nga zbatimi i politikave dhe reformave adekuate ekonomike dhe strukturore të cilat do të sigurojnë shfrytëzim racional të burimeve natyrore dhe burimeve njerëzore në Kosovë.

Pesë objektivat e SERK-së janë:

- sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm e cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike;
- integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë;
- rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja;
- zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror; dhe
- plotësimi i caqeve dhe obligimeve nëeficiencën energjetike, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit.

Objektiva e fundit lidhet kryekëput me zhvillimin e qëndrueshëm.

26. Strategjia për Ndryshimet Klimatike dhe PV për NK 2019-2028, Burimi: [https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/14-13-59-04102018/SNK_PV_NK__5%20tetor_2018_Final\[1\].pdf](https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/14-13-59-04102018/SNK_PV_NK__5%20tetor_2018_Final[1].pdf) Qasur me 18. 04. 2020

27. Strategjia për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2019-2023 Burimi: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/07/Strategjia.pdf> Qasur me: 27. 03. 2020

28. <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/objective>

29. <http://www.businessdictionary.com/definition/objective.html>

Rekomandime:

Të sigurohet komunikim dhe integrim sa më i madh i objektivave nëpër politikat zhvillimore në kuptimin e shfrytëzimit të resurseve dhe ruajtjes dhe mbrojtjes së ekosistemeve.

Objektivat për ndikimin dhe zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike të trajtohen edhe nga politikat e tjera zhvillimore: uji, transporti, biodiversiteti.

Të adresohen sa më shumë objektiva për qëndrueshmërinë ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në nivel lokal.

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (SMRK) në objektivin e saj të dytë përcakton që "politikat zhvillimore do të orientohen në drejtim të krijimit të legjislacionit për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit sipas standardeve ndërkombëtare, tërheqjes së investimeve private, reformimit të plotë të sektorit, mbrojtjes së mjedisit dhe trajtimit të çështjeve sociale të ndikuara nga aktiviteti minerar."

Ndërsa objektivat e Planit Hapësior të Kosovës (PHK) janë "planifikimi i hapësirës për shfrytëzimi racional i territorit; zhvillimi hapësor i balancuar; stimulimi i politikave të zhvillimit të zonave rurale; shfrytëzimi i mineraleve për një zhvillim të qëndrueshëm; mbrojtja e mjedisit; mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore; dhe rregullimi i ndërtimeve ilegale dhe vendbanimeve joformale". Pothuajse të gjitha prekin parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ose qëllimet e arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm. Nga ky aspekt, PHK-ja ka për qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, të zhvillimit të kontrolluar hapësor, si dhe mbrojtjen dhe respektimin e resurseve, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Rritja e efikasitetit të energjisë (EE) dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) do të kontribuojnë në realizimin e tri qëllimeve të politikës energjetike të vendit: mbështetjen për rritjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike (SKPVNK) si objektivë kryesore parasheh ngritjen e kapaciteteve të partnerëve, akterëve dhe hisedarëve qendrorë dhe lokalë për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes në proceset e zhvillimit. Më tutje dokumenti përcakton objektiva ambicioze të cilat i grupon në dy kategori: objektivat për zhvillimi të ulët dhe ato për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike. Kategoria e parë e objektivave përfshin: zhvillimin e kapaciteteve për t'u ballafaquar me ndryshimet klimatike dhe parandalimin e zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë, duke përfshirë mobilitetin e qëndrueshëm. Kategoria e dytë përfshin: zhvillimin dhe përmirsimin e mekanizmave për zvogëlimin e rrezikut në sektorët e rëndësishëm ekonomikë dhe sektorët e cënueshëm nga ndryshimet klimatike, ngritjen e kapaciteteve për përshtatje të ekosistemeve dhe ngritjen e kapaciteteve të partnerëve dhe akterëve të qeverisjes lokale e qendrore

për integrimin e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes ndaj zhvillimet e ardhshme. Në kuadër të projektit për ngritjen e kapaciteteve për kontrollin e cilësisë së ajrit në Kosovë, është zhvilluar një bashkëpunim mes ekspertëve të Universitetit të Prishtinës (UP) dhe të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) me qëllim të hulumtimit mbi rritjen e efikasitetit të elektrofilterëve të termocentralëve Kosova A dhe B, si dhe hartimin e masave për zvogëlimin e emetimit të gazrave nitroze NOx nga termocentralet.³⁰

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) në objektivin e saj të fundit (nga katër gjithsejt) përcaktohet për "shfrytëzimin e resurseve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik."

Strategjia për Vetëqeverisjen Lokale (SVL) si një nga objektivat e saj të parë përcakton "ritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore lokale dhe financiare të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal."³¹ Kjo arrihet përmes zhvillimit të politikave efektive për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike lokale, ndërtimit të infrastrukturës së rrugëve lokale dhe rrjetit të transportit, aftësisë të rinjve si fuqi punëtore, mbështetjes së bizneseve dhe zhvillimit të bujqësisë. Shumica e komunave të Kosovës, bazuar në LMM, kanë hartuar Planet Lokale të Veprimit në Mjedis përmes të cilave synohet të sigurohet qëndrueshmëria mjedisore e zhvillimit në nivel lokal. Komuna e Gjakovës, ndërkaq, me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka zhvilluar Strategjinë e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës.³² MPBAP-ja në baza gjashtëmujore dhe vjetore harton raportin mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të Strategjinë për Vetëqeverisjen Lokale (SVL) dhe deri më tani ajo është zbatuar vetëm nga MPBAP-ja, ani pse në parim Strategjia është dokument shumësektorial që më shumë përfshin akterë të tjerë sesa vetëm MPBAP-në.

30. Nga intervista me zyrtarin e MMPH

31. Strategjia për Vetëqeverisjen Lokale 2016-2026 Burimi: https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/08/Strategjia_liber_tri-gjuhe_finale-2016.pdf Qasur me: 18. 03. 2020

32. <https://www.yumpu.com/xx/document/read/7393517/strategjia-e-zhvillimit-te-qendrueshem-te-komunes-undp-kosovo> Qasur me 23.07. 2020

5.5

Masat për zhvillim të qëndrueshëm

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) parasheh masa të veçanta që do të sigurojnë edhe investime që do të mundësojnë "përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke siguruar balancim mes nevojave zhvillimore dhe kujdesit ndaj mjedisit." Këto masa janë trajtuar në kuadër të shtyllave strategjike si: infrastruktura, industria, minierat, kapacitetet e reja energjetike dhe energjia e qëndrueshme, shfrytëzimi racional dhe rritja e kapaciteteve për shfrytëzimin e resurseve ujore, shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, si dhe menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave.

Përdorimi efikas i shpenzimeve publike dhe investimeve private do t'i japë impuls rritjes ekonomike dhe do të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Industritë konkurruese bëjnë që rritja ekonomike të prodhojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Rritja e investimeve në sektorin minerar dhe të ardhurat shtesë në sektorin e industrisë do të mundësojnë normë më të lartë të rritjes ekonomike dhe zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Sigurimi i energjisë së qëndrueshme do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të të bërit biznes, do të mundësojë rritjen e investimeve private dhe do të përmirësojë bilancin tregtar të Kosovës duke i ulur importet. Furnizimi i qëndrueshëm do të përmirësojë edhe mirëqenien e qytetarëve. Rritja e investimeve do të mundësojë norma më të larta të rritjes ekonomike dhe të zhvillimit të qëndrueshëm. Përmirësimi i furnizimit me ujë do të shërbejë si mbështetës për rritjen e ndërmarrjeve dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Investimet dhe reformat në sektorin e pyjeve do të luajnë një funksion të rëndësishëm jo vetëm për mbrojtjen e mjedisit, por edhe për mbështetjen e zhvillimit industrial. Përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin më të mirë të pyjeve do të mbështesë industrinë e përpunimit të drurit, duke siguruar çmim të drejtë dhe furnizim të qëndrueshëm me lëndën e parë. Investimi në riciklim dhe trajtim të mbetjeve do të mundësojë ripërdorimin e aseteve dhe kthimin e tyre në funksion të zhvillimit për industrinë e trajtimit të mbetjeve dhe industritë e tjera që i përdorin materialet e ricikluara si lëndë të parë. Kjo do të mundësojë që rritja ekonomike të jetë më e qëndrueshme dhe me ndikim më të vogël negativ në mjedis.

Masa konkrete janë propozuar në Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës (SMRK), ku kërkohet "promovimi dhe zhvillimi i parimeve për zhvillim të qëndrueshëm (zhvillimi që plotëson nevojat aktuale, pa dëmton interesat e brezave që vijnë)." Nën objektivin e zgjidhjes së problemeve historike nga e kaluara nga aktiviteti minerar, si masë propozohet "rehabilitimi i zonave të kontaminuara nga veprimtaria minerare sipas praktikave më të mira ndërkombëtare". Për mbrojtjen mjedisore nga aktiviteti minerar parashihen masat si adoptimi i plotë i standardeve mjedisore evropiane dhe promovimi i përfshirjes së publikut në procesin e vendimmarrjes.

Shtylla 4 e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike (SKPVNK) (Infrastruktura) parasheh masa të veçanta për sigurimin e investimeve që do të mundësojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke siguruar balancë mes nevojave zhvillimore dhe kujdesit ndaj mjedisit. Tetë masat e Strategjisë për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike identifikojnë aktivitete/intervenime të cilat risin përfitimet, duke minimizuar njëkohësisht pasojat negative. Kjo përfshin veprime me kosto efektive për zvogëlimin e rreziqeve, të cilat mund të realizohen pa komprometuar trajektoret e zhvillimit të qëndrueshëm dhe opsionet e përshtatjes, të cilat sigurojnë përfitime pavarësisht kushteve të ardhshme klimatike. Në kuadër të kësaj, SKPVNM-ja parasheh masa për zvogëlimin e gazrave me efektin serrë në fushat e ngritjes së kapaciteteve, energjisë së ripërtëritshme dhe efikasitetit të energjisë, ngrohjes qendrore dhe kogjenerimit, termocentraleve dhe minierave të thëngjillit, transportit, bujqësia, pyjeve dhe natyrës, si dhe menaxhimin e mbeturinave.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës (SERK) parasheh një listë prej 60 masash për implementim të dizajnuara sipas objektivave strategjike (Tabela 1). Megjithatë, ndryshimet klimatike në SERK përmenden vetëm në dy vende dhe trajtohen në faqen e fundit të dokumentit, duke kërkuar një "studim që do të propozojë përgatitjen e planit për mbrojtjen e ajrit me masat e identifikuar lehtësuese për të mbrojtur shëndetin e njeriut." Duke ditur se sektori energjetik sidomos në Kosovë është kontribuesi kryesor i gazrave me efekt serrë, shihet se koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm në SERK është pothuajse inekzistent në aspektin përmbajtësor.

GRAF. 1 VALIDITETI I DOKUMENTEVE TË SHQYRTUARA NË HULUMTIM

Objektivi	Nr. i masave	Sfidë për zbatim
1. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm e cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike	14	Ndërprerja e projektit 'Kosova e Re' dhe mosmbyllja e TC 'Kosova A'; H.C. e reja
2. Integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë	12	Anëtarësimet në nismat rajonale (ENTSO-E, ACER)
3. Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja	8	Nuk janë përmendur sfida
4. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror	5	Marrëveshjet dhe infrastruktura për gazin
5.1. Plotësimi i caqeve dhe obligimeve për EE dhe mbrojtje të mjedisit	12	Performanca e ndërtesave
5.2. Plotësimi i caqeve dhe obligimeve për BRE dhe mbrojtje të mjedisit	9	One Stop Shop-et



Bashkimi Evropian (BE) me Rregulloren 2018/1999 (11 dhjetor 2018) obligon shtetet që prej vitit 2021 të adoptojnë një plan kombëtar të integruar për klimën me kohëzgjatje prej 10 vjetësh dhe që menjëherë pastaj përgatitet tjetri për 10 vjeçarin pasues. Kjo rregullore zbatohet për pesë dimensionet e Unionit të Energjisë, të cilat janë të lidhura ngusht dhe përforcojnë njëra-tjetrën: siguria e energjisë; tregu i brendshëm i energjisë; eficientia e energjisë; dekarbonizimi; hulumtimi, inovacioni dhe konkurrueshmëria. Qeveria e Kosovës ka themeluar grupet punuese për hartimin e Planit të Kosovës për Energji dhe Klimë (PKEN) për Kosovën 2021-30.

Një pjesë e masave nga Tabela 1 pritet që të inkorporohen edhe në PKEN të Kosovës. Pritet që të propozohen masa të detajuara brenda pesë dimensioneve rreth të cilëve dizajnohet. Në dimensionin për sigurimin e energjisë elektrike si masë prioritare propozohet zëvendësimi i kapacitetit të dekomisionuar me energji të pastër (gaz natyror: 300MW, dhe burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE):1200MW), duke përfshirë hartimin e Master Planit për gazin natyror, si dhe zëvendësimi i enegjisë për ngrohje nga ajo elektrike në ngrohjen qendrore.

Me dështimin e sërishëm të projektit 'Kosova e Re', nuk dihet nëse do të ketë komisionim sipas propozimit të SERK-së dhe Komisionit Evropian. Në dimensionin e tregut të brendshëm, parashihet përgatitja e infrastrukturës për gazin natyror dhe themelimi i Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit (OST). Te dimensionin i dekarbonizimit parashihen promovimi i qyteteve të mençura (smart cities), transportit dhe mobilitetit. Në dimensionin e energjisë së ripërtëritshme, propozohen studimet e fizibilitetit, infrastruktura ligjore dhe 30 mijë kulme me panela solarë deri më 2030. Caku i përgjithshëm i obligueshëm shtetëror i Planit Kombëtar për Veprim për Burimet

e Ripërtëritshme të Energjisë (PKVBRE) për pjesëmarrjen e energjisë nga BRE në bruto konsumin final të energjisë në vitin 2020 është 25%, i përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë për zbatimin e Direktivës 2009/28/EC dhe ndryshimin e nenit 20 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Megjithatë, Kosova do të synojë një cak më të lartë që korrespondon me 29.47% të bruto konsumit final të energjisë më 2020.³³ Te dimensionin i eficientës së energjisë parashihen masat e certifikimit dhe auditimet e standareve për eficientë, koogjenerimi i energjisë, si dhe incentiva ekonomike dhe vetëdijësimi i popullatës.

Plani Kombëtar për Veprim për Eficientë e Energjisë (PKVEE) ka vendosur cakun e ndërmjetëm indikativ për kursimin e energjisë prej 39 ktoe apo 3% e sasisë së gjithmbarshme të energjisë gjatë viteve 2010-2012 në sektorin e amvisërisë, shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë.³⁴ Rezultatet preliminare bazuar në raportin e Planit të parë afatmesëm të Kosovës për eficientë e energjisë (EE) tregojnë se caku i përcaktuar është arritur me 3.1% (SERK, f. 74). Cak indikativ i ngjashëm është vendosur edhe për periudhën 2012-15 dhe 2015-18, por për to nuk ka raporte nëse janë arritur.

Lidhur me eficientë e energjisë, Kosova ka bërë një hap pozitiv duke themeluar Fondin Kosovar për Eficientë e Energjisë (FKEE)³⁵. FKEE-ja si një subjekt i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm është themeluar për të mundësuar që Qeveria e Kosovës "të arrijë objektivat politike të saj për eficientë e energjisë përmes promovimit, mbështetjes dhe ose zbatimit të masave të eficientës së energjisë si dhe tërheqjes dhe menaxhimit të burimeve financiare për të financuar dhe zbatuar projektet e investimeve në fushën e eficientës së energjisë në mënyrë të qëndrueshme".

Sipas INDEP-it Kosova është vonuar në liberalizimin dhe hapjen e tregut të energjisë, integrimi i tregut me rajonin është duke shkuar shumë ngadalë dhe skema mbështetëse për konsumatorët me vetë-konsum është ende e mangët dhe e pamjaftueshme. "Ne do të donim të shihnim një sistem kompetitiv dhe me principe të tregut në fushën e incentivimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, të shihnim fillimin e zbatimit të Direktivës për biokarburante dhe diversifikim më të madh të burimeve të energjisë në lëmin e transportit. Pastaj investime më agresive në eficientë të energjisë, reformim të sistemeve të ngrohjes dhe strategji kombëtare të qartë për mbrojtjen e pyjeve, ujërave dhe për trajtimin të mbetjeve".³⁶

33. [https://mzhe-ks.net/repository/docs/Plani_Kombetar_j_Veprimit_per_Burimet_e_Ripertertshme_te_Energjise_\(PKVBRE\)_2011-2020.pdf](https://mzhe-ks.net/repository/docs/Plani_Kombetar_j_Veprimit_per_Burimet_e_Ripertertshme_te_Energjise_(PKVBRE)_2011-2020.pdf) (Prill 2020)

34. *Plani i Veprimit të Kosovës për Eficientë e Energjisë 2010-18 Burimi:* [https://mzhe-ks.net/repository/docs/Plani_j_Veprimit_j_Kosoves_per_Eficience_te_Energjise_\(PKVEE\)_2010-2018.pdf](https://mzhe-ks.net/repository/docs/Plani_j_Veprimit_j_Kosoves_per_Eficience_te_Energjise_(PKVEE)_2010-2018.pdf)

35. [https://mzhe-ks.net/repository/docs/LIGJI_NR._06_L-079_PER_EFICIENCE_TE_ENERGJISE_\(1\).pdf](https://mzhe-ks.net/repository/docs/LIGJI_NR._06_L-079_PER_EFICIENCE_TE_ENERGJISE_(1).pdf)

36. *Citim nga Dardan Abazi, INDEP*

5.6. Zhvillimi i qëndrueshëm si prioritet

Prioriteti sipas fjalorëve modernë përkufizohet si “diçka që është shumë e rëndësishme dhe duhet të trajtohet para gjërave të tjera”³⁷ ose “fakti ose gjendja për t’u konsideruar ose trajtuar si më e rëndësishme se të tjerët”.³⁸ Si prioritet zhvillimi i qëndrueshëm adresohet në katër dokumente strategjike.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) ka parashikuar katër masa prioritare për zhvillimin e sektorit të energjisë: ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese dhe energjia e qëndrueshme; krijimi i një tregu të hapur dhe konkurrues të energjisë elektrike; ulja e konsumit të energjisë përmes masave eficiente dhe shfrytëzimi racional i burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM) në prioritetet afatgjate përcakton “përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët; zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe kulturor”. Te prioritetet sektorale, prioriteti 7 (Shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore) përcakton “mbështetjen e politikave mjedisore të zhvillimit në mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të të gjitha burimeve natyrore si janë uji, mineralet e pyjet”.

Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës (SSHUK), për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik (prioritet 1 i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim), vendos ndër prioritetet edhe: investimet në projekte të mëdha, përmes modernizimit dhe zhvillimit të infrastrukturës publike; mbështetjen e vazhdueshme të zhvillimit rural dhe bujqësisë, në mënyrë që të rritet prodhimi vendor, si dhe dhe investimet që kanë të bëjnë me menaxhimin e mjedisit dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (SPVB) adreson prioritetet strategjike sektorale për zhvillimin e qëndrueshëm. Kështu, te prioritetet strategjike për pylltarinë parashihet që “menaxhimi me pyjet të bëhet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm duke shfrytëzuar 60% të shtimit vjetor dhe të pyllëzime në toka të zhveshura pyjore me lloje autoktone.” Ndërsa për turizmin parashihet zhvillimi i një strategjie për turizëm të qëndrueshëm dhe miqësor me natyrën që plotëson kërkesat për ruajtjen e biodiversitetit.

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (SMRK) si prioritetin e saj nr. 7 vendos “shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore... mbështetjen e politikave mjedisore të zhvillimit në mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të të gjitha burimeve natyrore si ujërat, mineralet dhe pyjet”. Zbatimi i objektivave, masave dhe prioriteteve të SMRK-së bëhet përmes Programit për Zbatimin e SMRK-së si një program për periudhë trevjeçare. Monitorimi i zbatimit të SMRK, bazuar në Ligjin nr/ 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, është përgjegjësi e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ambient përmes Raporteve vjetore të Progresit të Programit për zbatimin e SMRK-së.

37. <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/priority> (Prill 2020)

38. <https://en.oxforddictionaries.com/definition/priority>



5.7. Zhvillimi i qëndrueshëm në parime

Sipas fjalorit Cambridge, parimi përkufizohet si "një ide ose rregull themelor që shpjegon ose kontrollon se si ndodh ose funksionon diçka".³⁹ Në Planin Hapësinor të Kosovës (PHK), parimi i zhvillimit të qëndrueshëm nga aspekti i zhvillimit hapësinor nënkupton zhvillimin e qëndrueshëm që mbulon jo vetëm zhvillimin ekonomik, por edhe atë mjedisor, që ruan resurset e tashme për t'u përdorur nga gjeneratat e ardhshme, por gjithashtu përmban edhe zhvillimin e balancuar hapësinor. Edhe pse parimi i zhvillimit të qëndrueshëm është inkorporuar brenda Ligjit për Planifikimin Hapësinor, por edhe në standarde dhe agjenda të ndryshme, është koha që këto parime të përkthehen në veprime konkrete dhe të reflektohen në menaxhim. Zhvillimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm janë me rëndësi kryesore për një të ardhme më të mirë dhe kërkojnë vëmendje më të madhe në Kosovë.

Te Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM), parimi 3 (Ndryshimi i sjelljes ndaj prodhimit dhe konsumit) thekson se "zhvillimi efikas i politikave të mjedisit të bazuara në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm mund të jenë të suksesshme, pa ndryshuar sjellja e individit ndaj prodhimit dhe konsumit". Ndërsa te SSHUK përmendet parimi i barazisë në ndarjen e resurseve ujore.

Te kapitulli i parimeve themelore të Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturisë (SRKMM)⁴⁰, nën parimin: "j" - Përgatitja për tregun e hapur", inkurajohet menaxhimi i segmenteve tjera të shoqërisë duke përdorur instrumente ekonomike dhe forma tjera në përkrahje të menaxhimit të mbeturisë në përputhshmëri me kërkesat për ruajtjen e mjedisit dhe komizën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.⁴¹

Strategjia për Zhvillimin e Pyjeve (SZHP) kërkon që pyjet dhe tokat pyjore në Kosovë të menaxhohen në pajtueshmëri me parimet për konsensusin global të menaxhimit dhe mbrojtjes dhe zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve. Këtu përfshihen parimet parandaluese, parimet e barazisë ndërmjet gjeneratave, konservimi i larmisë biologjike dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekologjik.⁴²

Nga sa u tha më lart, mund të shihet se koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm është pjesë integrale e dokumenteve strategjike nën kapituj specifikë. Përfshirja më e madhe është te kapitujt e objektivave dhe masave të dokumenteve strategjike, ndërsa pak dokumente strategjike të hulumtuara e kanë të përfshirë konceptin në misionin, vizionin dhe qëllimet e tyre. Duke parë këto zhvillime, aprovimin e pakos prej rreth 20 ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, por edhe në ndërlidhje të vazhdueshme me Marrëveshjen e Gjelbër Europiane (European Green Deal), mund të konsiderohet se ka një orientim shpresëdhënës për zbatimin e parimeve të qëndrueshmërisë në hapat e ardhshëm zhvillimorë të vendit.

39. <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/principle>

40. Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Mbeturisë, Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjise_se_Republikes_se_Kosoves_per_Menaxhimin_e_Mbeturise.pdf Qasur me 20. 03. 2020

41. SRKMM ndër të rrallat që ka një kosto të planifikuar 133.85 milion euro për 10 vitet e ardhshme, por jo të specifikuar as në shtylla të trasha se nga do shpenzohen ato.

42. Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020 Burim: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_per_Zhvillimin_e_Pylltarise_2010-20.pdf Qasur me 25. 04. 2020



6. Përfshirja e akademisë në zhvillimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike

Qeveria e Kosovës ka hartuar Udhëzimin Administrativ nr. 07/2018⁴³ dhe Manualin për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit⁴⁴, ku pika 2.9 e nenit 8 parasheh që në grup punues të jenë edhe përfaqësues të shoqërisë civile, akademikë, këshilltarë ose ekspertë të jashtëm. U përket institucioneve përkatëse që të hartojnë planet e punës, të cilat pastaj dërgohen në Zyrën e Kryeministrit (ZKM) - për t'u hartuar Plani i Punës së Qeverisë - dhe monitorohen çdo 3 muaj. Orientimi i ZKM-së për të ardhmen është konsolidimi i dokumenteve strategjike duke hartuar dokumente sektoriale, për të identifikuar dhe analizuar mbivendosjet, ndeshjet dhe ndërlidhjet mes dokumenteve të sektorëve të ndryshëm. Në kuadër të kësaj, do bëhet koncepti për Sistemin e Dokumenteve Strategjike dhe koncepti për Strategjinë e Re Kombëtare për Zhvillim. Sa i përket monitorimit dhe raportimit, neni 16 i Udhëzimit Administrativ (07/2018), si dhe kapitulli 8 i Manualit për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike rregullojnë procedurat se si duhet raportuar mbi zbatimin e dokumenteve strategjike.⁴⁵

Shumica e të intervistuarve në hulumtim theksojnë se përfshirja e akademisë ka qenë vetëm simbolike për shkak të neglizhencës nga ana e institucioneve të Qeverisë. Janë formuar grupe punuese, por në mungesë të fondeve për kompensimin e akademikëve, këta të fundit nuk janë angazhuar më tutje. Në hartimin e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës (SERK) kanë qenë të përfshirë profesorë nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK). Në hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Pyjeve (SZHP) dhe dokumenteve tjera përcjellëse kanë marrë pjesë profesorë nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (FB), Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore (FSHMN) të UP-së por edhe nga universitete nga rajoni dhe Suedia.⁴⁶ Në hartimin e disa dokumenteve strategjike që burojnë nga Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit, në skemat e përfaqësimit të institucioneve shkencore e hulumtuese, parashihet pjesëmarrja e ekspertëve nga akademia.⁴⁷ Njëkohësisht, brenda vitit 2020 parashihet rishikimi i Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës (SERK). Megjithatë, duhet ngritur përgjegjësia e institucioneve sponzoruese të dokumenteve strategjike për të siguruar kapacitete njerëzore profesionale dhe burime financiare.

Nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) konfirmohet se në grupe punuese dhe diskutime të dokumenteve politike zhvillimore janë përfshirë vazhdimisht të gjithë akterët relevantë të fushës së arsimit, pra edhe institucionet hulumtuese dhe akademia. Pjesëmarrja, angazhimi dhe kontributi i secilit nga ta nuk është varur nga MASHT-i, por nga vetë vullneti i tyre për të kontribuar. Në perspektivën e zbatimit të dokumenteve strategjike, vështirësitë vijnë nga mospërfshirja e

akterëve të tjerë në zbatimin e Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK).⁴⁸ Këtu duhet të përfshihen të gjitha institucionet, deri te komuna, shkolla, institutet dhe universitetet. Pra, ngecjet ndodhin atje ku duhet të zbatohen objektivat strategjike, në institucionet e lartpërmendura.⁴⁹

Institucionet hulumtuese dhe ato akademike kanë pasur rastin që të përfshihen në të gjitha politikat e krijuara nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP) dhe kjo është bërë përmes konsultimeve publike dhe në vazhdimësi kanë dhënë kontributin e tyre. Gjithashtu, në kuadër të planit të veprimit të SVL-së 2016-2026, objektivi 4 parasheh përfshirjen e të gjithë akterëve të cilët mund të japin kontribut në zbatimin e saj (duke kuptuar këtu edhe institucionet hulumtuese e akademike). Në aspektin procedural, dokumentet pas përfundimit nga ana e grupit punues dërgohen në Ministrinë e Financave për marrjen e opinionit të tyre dhe pastaj në ZKM për aprovim. Lidhur me zhvillimet në të ardhmen, MAPL-ja ka planifikuar hartimin dhe miratimin e Programit për Rishikimin Funkcional të Qeverisjes Lokale. Aspektet e tjera të zbatimit të dokumenteve strategjike lidhen me emërimin e zyrtarëve, monitorimin e tyre dhe hartimin e raportit në baza gjashtëmujore dhe vjetore.⁵⁰

Shoqëria civile gjithashtu është duke kontribuar në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në politikat zhvillimore të vendit. INDEP-i, si një organizatë think tank lidere në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm, atë e ka në misionin e vet, por është edhe njëri nga tre programet e punës së organizatës. "Ne përcjellim të gjitha institucionet që merren me fushën e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë dhe reagojmë përmes ofrimit të alternativave, hulumtimit dhe ndërtimit të koalicioneve dhe rrjeteve me organizata të tjera. Ne kemi udhëhequr përpjekjet për ta

43. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18813> Qasur me 20.08. 2020

44. <https://kryeministri-ks.net/documents/manual-per-planifikimin-hartimin-dhe-monitorimin-e-dokumente-ve-strategjike-dhe-planeve-te-tyre-te-veprimit/> Qasur me 20.08. 2020

45. Nga intervista me zyrtarin e ZKM

46. Nga intervista me zyrtarin MBPZHR

47. Nga intervista me zyrtarin e MMPH

48. http://kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf

Qasur me 19. 08. 2020

49. Nga intervista me zyrtarin e MASHT

50. Nga intervista me zyrtarin e MAPL

futur EE në agjendën politike duke ndihmuar komisionin parlamentar për të monitoruar legjislacionin, inicuar ndryshimin e tij dhe duke mbështetur grupin punues në hartimin e legjislacionit. Ne gjithashtu kemi përcjellur legjislacionin në fushën e BRE-së, kemi qenë të parët që kemi folur dhe promovuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe të parët që po ndërlidhim mbrojtjen e konsumatorit me zhvillimin e qëndrueshëm”.⁵¹

Rritja e njohurive dhe kapaciteteve organizative që të funksionojmë me metodat dhe përjasjet më të fundit globale dhe rajonale të zhvillimit të qëndrueshëm në aktivitete është kërkesë edhe e organizatave joqeveritare. “Zhvillimi i qëndrueshëm është i internalizuar në korizën ideologjike të organizatës, pasi misioni i saj është të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme urbane dhe rurale për zhvillim harmonik. Permakultura njihet si korizë inovative për krijimin e sistemeve të vetëqëndrueshme. Si korizë, ajo bazohet në qëndrueshmërinë regjeneruese. Çfarëdo intervenimi programor i cili nuk mëton të krijojë qëndrueshmëri dështon në plotësimin e kriterëve bazë të Permakulturës. Si rrjedhojë, Fondacioni Jeshil në fazën e konceptimit të programeve, për të kaluar prapë ideologjik, duhet të mëtojë zhvillimin e qëndrueshëm”.⁵²



51. Citim nga intervista me Dardan Abazin, Udhëheqës i Hulumtimit dhe Menaxher i Programit, INDEP

52. Citim nga intervista me Xhevdet Gegolla, nga "Fondacioni Jeshil"

7. Konkluzionet rreth dokumenteve strategjike


Në këtë hulumtim janë analizuar 15 dokumente të politikave zhvillimore që prekin zhvillimin e qëndrueshëm në vend. Sipas natyrës së tyre katër dokumente të analizuar merren me zhvillimin ekonomik të gjithëmbarshtëm dhe qeverisjen: dy në nivelin shtetëror (SKZH dhe PHK) dhe dy në nivelin lokal (SZHEL dhe SVL). Katër dokumentet e analizuar trajtojnë shfrytëzimin e resurseve natyrore për nevoja zhvillimore siç janë: uji (SSHUK), minierat (SMRK) dhe energjia (SERK), dhe pyjet (SZHP). Ndërsa shtatë dokumente adresojnë orientimet strategjike të qëndrueshmërisë sipas sektorëve të tij: mbrojtjen e gjithëmbarshtëm të mjedisit (SMM), mbeturinat (SRKMM), biodiversitetin (SPVB), ndryshimet klimatike (SKPVNK), eficiencën e energjisë, si dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Katër nga dokumentet strategjike të analizuar skadojnë në vitin 2020, ndërsa dokumenti me afat më të gjatë është SSHUK-ja që është i vlefshëm deri në vitin 2036. Nga dokumentet e analizuar del se SERK-ja e përmend konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë kapitujt e saj përveç qëllimit dhe prioritetëve të tyre. SPVNB-ja e përmend konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm në 4 nga kapitujt, sikurse edhe SMRK. Në 3 kapituj të ndryshëm, zhvillimin e qëndrueshëm e përfshijnë: SSHUK-ja PHK-ja, SMM-ja dhe SZHEL-i. Ndërsa, SKZH-ja e përmend vetëm tek masat, që u referohet në fakt dokumentave të konsultuara gjatë hartimit të saj, ashtu sikurse edhe PKENK-ja, PKVBRE-ja dhe PKVNEE-ja.

Vërehet një shkëputje ndërmjet kapitujve që sigurojnë zbatimin e plotë të politikave. P.sh. SZHP-ja e përmend zhvillimin e qëndrueshëm si prioritet, por nuk e trajton askund në kapitujt e vet qëndrueshmërinë si koncept. Ose e kundërta: SPVB-ja e trajton qëndrueshmërinë në qëllimin e vet dhe e priorizon atë, por pa propozuar në dokument objektiva e as masa për ta arritur qëllimin.

TABELA 2. PËRFSHIRJA E KONCEPTIT TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË KAPITUJT E DOKUMENTAVE STRATEGJIKE NË KOSOVË (SQARIM: √- EKZISTON; X- NUK EKZISTON)

Dokumenti strategjik	Kohëzgjatja	Qëllimi	Mision	Vizion	Objektiva	Masa	Prioritete	Parim
SKZH	2016-21	X	X	X	X	√	X	X
SPVB	2011-20	√	X	X	X	X	√	X
SSHUK	2017-36	√	X	X	X	X	√	√
SERK	2017-26	X	√	√	√	√	X	√
SRKM	2012-25	X	X	X	X	X	X	√
SPVNK	2019-28	√	X	√	√	√	X	X
SZHEL	2019-23	√	X	√	√	X	X	X
SRKMM	2013-22	X	√	X	√	√	√	X
SMM	2013-22	X	X	√	√	X	√	X
PHK	2010-20+	X	X	√	√	X	X	√
SVL	2016-26	X	X	X	√	X	X	X
SZHP	2010-20	X	X	X	X	X	√	X
SKZH	2016-21	X	X	X	X	√	√	X
PKVBRE	2011-20	X	X	X	X	√	X	X
PKVNEE	2010-18	X	X	X	X	√	X	X



Politikat zhvillimore dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

Shkenca e qëndrueshmërisë fokusohet në bashkëveprimet dinamike ndërmjet natyrës dhe shoqërisë. Kuptimi substancial i këtyre ndërveprimeve është arritur në dekadat e fundit nëpërmjet punës në shkencat e mjedisit që përfshin veprimin njerëzor në mjedis dhe ndikimet mjedisore të njerëzit, përmes studimeve sociale dhe zhvillimore që synojnë të masin ndikimet mjedisore, si dhe përmes organizimit të hulumtimeve ndërdisiplinare, që ende janë në shkallë të ulët por në rritje e sipër. Në përgjithësi sot njihen katër tipare kyçe të shkencës së qëndrueshmërisë, që praktikuesit e saj i kanë identifikuar si dalluese për shkencën e qëndrueshmërisë në një mënyrë të veçantë.

1. *Normativiteti* - Shkenca e qëndrueshmërisë pranon në mënyrë eksplicite një kontekst normativ të qëndrueshmërisë (Clark & Dickinson 2003⁵³). Duke qenë se “qëndrueshmëria” dhe “zhvillimi i qëndrueshëm” janë kontestuar si koncepte (a mund të ketë qëndrueshmëri përballë një zhvillimi të vazhdueshëm), janë argumentuar shumë përkufizime dhe qasje të tyre.

2. *Urgjenca* - Në shkencën e qëndrueshmërisë urgjenca dhe shqetësimet morale janë thelbësore. Ata të cilëve u duhet të përmbushin nevojat thjesht mund të mos jenë gjallë në planin afatgjatë. Ekziston ende një aspekt tjetër i urgjencës: në rastin e ndryshimeve klimatike, reziqet që lidhen me pritjen për një shkencë më të mirë gjykohen shumë të larta.

3. *Ndërlidhja e mjedisit dhe shoqërisë* - Shkenca e qëndrueshmërisë kërkon të “kuptojë karakterin bazik të ndërveprimeve ndërmjet natyrës dhe shoqërisë” për të gjetur mënyra të përbashkëta në të cilat shkencëtarët natyrorë dhe socialë mund të përmirësojnë kuptimin e marrëdhënieve mjedisore dhe shoqërore. Mjetet tipike për përpjekje të tilla janë teknikat e skenarit që varen nga informacioni dhe mekanizmat shkakësorë në shkencat natyrore dhe shoqërore.

4. *Përfshirja e jo-shkencëtarëve* - Shkenca e qëndrueshmërisë në përgjithësi pranon përfshirjen e jo-shkencëtarëve në procesin e hulumtimit. Në këtë mënyrë supozohet që jo-shkencëtarët mund të kontribuojnë në projekte në terren në mënyra që shkencëtarët e përfshirë nuk mund ta bëjnë.

53. Clark, W., & Dickson, N. (2003). Sustainability science: the emerging research program. *Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America* 100 (14), 8059–8061.

8.1

Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm u mundëson të gjithëve që të marrin vendime të informuara për integritetin e mjedisit, qëndrueshmërinë ekonomike dhe një shoqëri të drejtë për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme, duke respektuar diversitetin kulturor. Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), edukimi për zhvillim të qëndrueshëm përfshin: integrimin e çështjeve kyçe të zhvillimit të qëndrueshëm në mësimdhënie dhe të nxënimit... ku mund të përfshihet, p.sh. mësimdhënia për ndryshimet klimatike, zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, biodiversitetin, uljen e varfërisë, konsumin e qëndrueshëm, etj...kërkon metoda pjesëmarrëse të mësimdhënies dhe të nxënimit që i motivojnë dhe u japin mundësi nxënësve të ndryshojnë sjelljet e tyre dhe të ndërmarrin veprime për zhvillim të qëndrueshëm...edukimi për zhvillim të qëndrueshëm rrjedhimisht promovon kompetenca si të menduarit kritik, të imagjinuarit e skenarëve të ardhshëm dhe marrjen e vendimeve në mënyrë bashkëpunuese. Në terma të përgjithshme “qëllimi i edukimit për qëndrueshmërinë është të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë një botëkuptim të qëndrueshëm, një mënyrë për të parë dhe bashkëvepruar me botën përmes lenteve të qëndrueshmërisë”.

Hulumtimet e shumta kanë treguar se edukimi ndihmon popujt që të arrijnë objektivat e një zhvillimi të qëndrueshëm. Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm mbart me vete idenë e pandarë të zbatimit të programeve zhvillimore që janë relevante në nivel lokal dhe kulturor. Të gjitha programet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë edukimin për qëndrueshmërinë, duhet të marrin parasysh kushtet lokale mjedisore, ekonomike dhe shoqërore.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) kërkon “përputhje më të madhe të shkathtësive të fuqisë punëtore me nevojat e tregut të punës që do të ndihmojë në rritjen e investimeve, punësimin, të ardhurave dhe ndërmarrjeve ekzistuese, dhe e gjithë kjo do të mundësojë rritje më të lartë ekonomike dhe zhvillim më të qëndrueshëm”. Për të arritur këtë parashihet ndërhyrje konkrete në 3 fusha:

1. Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore - që do të mundësojë sukses më të madh në nivele më të larta të arsimit, uljen e pabarazisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Kjo do të thotë se një fëmijë mund të mësojë ndërkohë që nëna e tij punon.
2. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm - si një parakusht për sukses më të madh të sistemit të arsimit dhe forcimit të aftësive të të rinjve për tregun e punës.
3. Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës - që do të kontribuojë në uljen e papunësisë dhe rritjen e ndërmarrjeve kosovare. Kjo do të thotë se një nxënës/e i/e shkollës profesionale apo student/e nga universiteti do të mund të gjejnë më lehtë punë praktike gjatë studimeve apo angazhim të plotë pas studimeve.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike (SKPVB) thekson nevojën për edukim për ruajtjen e biodiversitetit që rrjedh nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, ku një nga synimet është

“edukim dhe arsimim me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së larmisë biologjike dhe peizazhore”. Kjo adresohet në Objektivin strategjike 4 si “promovim i edukimit dhe komunikimit efektiv për biodiversitetin”. Më tej, dy nga gjithsej katër objektivat strategjike lidhen me edukimin: plotësimi dhe zbatimi i kurrikulave në të gjitha nivelet; dhe rritja e bashkëpunimit ndër-institucional dhe me OJQ-të për edukimin mjedisor. Te prioritetet sektorale gjithashtu adresohet përfshirja në edukim e fermerëve për ruajtjen e biodiversitetit, me fokus në përdorimin e plehrave kimike dhe pesticideve me veprim të gjërë në mjedis.

Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM) - Një nga objektivat e dokumentit është “zhvillimi i programeve arsimore, fushatave të ndërgjegjësimit dhe mbështetja për projektet shkencore të fokusuara në mjedis”. Objektivat e politikave mjedisore në kuadër të SMM-së adresojnë “integrimin e çështjeve të mjedisit në kurrikulat mësimore në të gjitha nivelet e arsimit”. Objektivat e SMM-së në fushën e edukimit përfshijnë “integrimin e çështjeve të mjedisit në kurrikulat mësimore në të gjitha nivelet e arsimit (leksione të zgjedhura me përmbajtje që lidhen me çështjet e mjedisit)” dhe “përkrahjen institucionale e financiare me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut (shpërndarjen e informacionit dhe edukimin për çështjet e mjedisit)”. Objektivat e fushës kërkimore-shkencore në SMM synojnë “transferimin e teknologjive të pastra dhe shfrytëzimin e burimeve të reja energjitike të favorshme për mjedisin”. Ndërsa objektivat në kuadër të hulumtimit adresojnë “zhvillimin e mëtejshëm të qendrave të ekselencës për forcimin e kapaciteteve institucionale e njerëzore që kanë të bëjnë me kërkimin në fushën e mjedisit” si dhe “transferin e teknologjive të pastra dhe shfrytëzimin e burimeve të reja energjitike të favorshme për mjedisin”. Në prioritetet strategjike të SMM-së përfshihen “përfshirja më e madhe në kurrikulë e çështjeve mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm” dhe “mbështetja e OJQ-ve në lidhje me arsimimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për çështjet e mjedisit”. Prioritetet për hulumtim dhe zhvillim përfshijnë: krijimin e kapaciteteve institucionale të specializuara shkencore; mbështetjen financiare për institucionet shkencore; dhe sidomos zhvillimin e personelit të tyre.

Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës (SSHUK) adreson çështjen e edukimit në dy nga masat e saj të cilat kërkojnë që “të sigurohet që kurrikula shkollore të përfshijë përmbajtje të duhur që ka të bëjë me ujërat” si dhe “zhvillimin akademik të disa programeve universitare bachelor e master për mjedis, respektivisht ujëra”. Te kurrikula shkollore propozohen përmbajtje të duhura që kanë të bëjë me ujërat, duke përfshirë: çarkullimin e ujit, shfrytëzimin, ndotjen dhe kursimin e ujit, parandalimin e ndotjes së ujërave dhe rrezikun nga vërshimet. Kështu si prioritet shihen zhvillimi i kurseve multidisciplinore nga fushat e resurseve natyrore, menaxhimit të mjedisit dhe ujërave në nivelin master (MA), ku studentët do të zhvillojnë dy kompetenca kyçe. Janë propozuar programe të reja master (programi Menaxhim Mjedisit dhe Programi Hidroteknikë) si dhe përmirësimi i programeve master në Menaxhimin e Resurseve Natyrore dhe atij të Prodhimit të Bimëve, të gjitha këto në kuadër të UP-së. Në aspektin e hulumtimit dhe kërkimit shkencor, SSHUK-ja kërkon themelimin e njësisë hulumtuese (5-30 ekspertë të interesit të përbashkët) me fokusim te ndotja e ujërave dhe metodologjitë e largimit të ndotjes.

Ekziston gjithashtu qasja strategjike për një “qendër të ekspertizës teknike në sektorin e ujërave” që mbështet të gjitha institucionet e nën-sektorëve për adresimin e sfidave në menaxhimin e ujërave. Kjo qasje është zhvilluar konceptualisht për Institutin e Ujërave⁵⁴ dhe vëmendje gjithashtu i është kushtuar nevojës për zhvillim akademik për të mbështetur argumentin e ekspertizës teknike në këtë sektor për vitet në vijim.

54. I paqarte statusi dhe ekzistenca e këtij Instituti.

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM) - vendos si orientim edhe qëllim “edukimin e publikut” rreth mbeturinave. Prioritet dhe rëndësi të madhe gjithashtu do t’i jepet çështjeve të menaxhimit të mbeturinave në kurrikulat dhe programet arsimore pasi çështjeve të menaxhimit të mbeturinave nuk i kushtohet aktualisht vëmendje e duhur për të nxitur ndryshime sociale. Një ndër masat për arritjen e objektivave të Strategjisë është “zhvillimi i sistemit për edukim, raportim dhe komunikim për menaxhimin e mbeturinave” që përfshin “hartimin e kurrikulave në sistemin arsimor për të mundësuar pjesëmarrjen në sistemin e menaxhimit të mjedisit dhe të mbeturinave përmes programeve shkollore, mediave ose punëtorive të ndryshme”. Në kuadër të masave të veçanta për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave prioritet dhe rëndësi të madhe në SRKMM i jepet “çështjeve të menaxhimit të mbeturinave në kurrikulat dhe programet arsimore”. Masat bashkë me koston e tyre janë planifikuar për zhvillimin e kurrikulave dhe programeve të edukimit mjedisor lidhur me mbeturinat për të gjitha nivelet (kopshtet, shkollat, kolegjet, universitetet).

TABELA 3. PËRFSHIRJA E EDUKIMIT DHE E SHKENCËS SË QËNDRUESHMËRISË NË DOKUMENTET STRATEGJIKE TË ANALIZUARA (SQARIM: √- EKZISTON X-NUK EKZISTON)

Dokumenti	Shkathtësi	Kurrikula	Programe arsimore	Hulumtim	Projekte shkencore	Programe BA MA	Kapacitete të reja
SKZH	X	X	X	X	X	X	X
SPVB	X	√	√	X	X	X	X
SSHUK	X	√	X	√	X	√	√
SPVNK	X	X	X	X	X	X	X
SMRK	X	X	X	X	X	X	√
SMM	X	X	√	√	√	X	X

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike (SKPVNK) - parasheh që realizimi i masave të parapara aktivisht kontribuon në zvogëlimin e emisioneve të GHG-ve dhe parandalimin e fatkeqësive nga ndryshimet klimatike përmes kombinimit të zbatimit të legjislacionit, përforcimit teknik dhe edukimit. Në shtojcën 5 (Resurset e ujit dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike) theksohet se për t’iu përgjigjur sfidave ndaj ndryshimeve klimatike, Kosova duhet të hartojë strategji dhe plane veprimi për të integruar masat e zbutjes duke u bazuar në hulumtime gjithëpërfshirëse shkencore të vlerësimit të ndikimeve të mundshme të ndryshimeve klimatike në resurset ujore. Mirëpo, asnjë aktivitet apo masë nuk propozohet në Planin e Veprimit. Sipas SKPVNK-së, në Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Ndryshimet Klimatike propozohet të jetë një anëtar nga UP-ja.

Strategjia për Zhvillimin e Pyjeve (SZHP) - si prioritet të lartë vendos edhe “krijimin e mundësive për edukim dhe trajnim cilësor për të gjitha kategoritë e stafit që punon në sektorin pyjor”. Përballë këtyj sfondi, kërkohet që të krijohet një edukim profesional i mirëfilltë për profilin e pylltarisë dhe sistem i qëndrueshëm i aftësimeve profesionale; të krijohen mundësi për zhvillimin e arsimit të lartë për pylltari; dhe të vlerësohen nevojat për krijim të premisave për hulumtime shkencore.



Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) - Trendet bashkëkohore tregojnë se është në rritje interesimi për sektorin e planifikimit hapësinor dhe se kushti për një ekonomi dhe zhvillim të qëndrueshëm është edukimi i mirëfilltë i individit dhe shoqërisë. Në kontekst të edukimit për zhvillim të qëndrueshëm, dokumenti i referohet Strategjisë së Arsimit të Lartë (2005-15) e cila thekson se “duke ndërtuar një sistem cilësor e fleksibil të arsimit të lartë që u përgjigjet kërkesave të shoqërisë, do të krijohen parakushte që arsimit të lartë të jetë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë”. Duhet më shumë bashkëpunim ndërmjet diciplinave në universitete, institucioneve publike dhe organizatave ndërkombëtare. “Universitetet në Kosovë prodhojnë dijen por nuk janë akterë në proceset zhvillimore për qytetet e qëndrueshme”.⁵⁵

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (SMRK) në kuadër të objektivit 2 (Zhvillimi institucional dhe i kapaciteteve njerëzore) përveç funksionalizimi të Institutit Gjeologjik të Kosovës parasheh zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese dhe teknologjike duke mbështetur institucionet kërkimore shkencore dhe universitetet. Gjithashtu, kërkohet ngritja e kapaciteteve edukativo-arsimore të specialistëve të gjeologjisë, minierave, ekonomisë, mjedisit dhe shkollimi inxhinierik adekuat nga universiteti publik për të prodhuar kuadro të gatshme që të përballojnë sfidat dhe kërkesat e institucioneve.

Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës (SERK) në asnjë vend nuk përmend hulumtimin shkencor, inovacionin dhe edukimin në masat e propozuara për zbatimin e strategjisë. Objektivi i parë i SERK-së në masën e 11 parasheh që “të merren masa për përfshirjen e përshtatjen e programeve universitare me nevojat e tregut të punës që krijohet në procesin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re”.

55. Citim nga intervista me Eliza Hoxha, FNA- UP.

8.2

Zhvillimi i qëndrueshëm në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (KKK)

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm në KKK definohet si “proces i zhvillimit të njohurive të nxënësve, i të kuptuarit, i shkathtësive dhe attributeve të nevojshme për të punuar dhe jetuar në një mënyrë që mbron mirëqenien mjedisore, sociale dhe ekonomike, si në të tashmen dhe për brezat e ardhshëm”. Nevoja për zhvillim të qëndrueshëm shprehet qysh në hyrjen e dokumentit e është marrë edhe si një ndër arsyet e reformës kurrikulare. Kështu, shprehet nevoja që në botë të globalizuar, ku cilësia e jetës për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm është e kërcënuar, nxënësit duhet të pajisen me dije, shkathtësi dhe qëndrime për t’u kujdesur me përgjegjësi për mjedisin e krijuar nga natyra dhe nga dora e njeriut, në mënyrë që t’i shmangen shpërdorimit të burimeve dhe praktikave të tjera të papërgjegjshme.

Njëri ndër qëllimet e arsimit sipas KKK-së është: “zhvillimi i përgjegjesisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit” dhe “zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm”. Nxënësit do të zhvillojnë përgjegjësinë për mjedisin në kontekst të vetëdijesimit për arsimin për zhvillim të qëndrueshëm.

KKK-ja është kurrikulë e bazuar në kompetenca.⁵⁷ Te kompetenca për jetë, punë dhe mjedis, synohet që përmes angazhimit për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit të krijohet një kontribues produktiv për shoqërinë ashtu që nxënësit të përgatiten të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale. Si rezultat i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, KKK-ja synon të përgatisë një qytetar të përgjegjshëm që të mbrojnë mjedisin natyror dhe artificial dhe të kontribuojnë për zhvillim të qëndrueshëm. Te pjesa e parimeve, KKK-ja bën promovimin e ndërlidhjes ndërlëndore me qëllim të promovimit të edukimit për zhvillim të qëndrueshëm si dhe “integrimin e risive, që reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore apo të shkencës në funksion të arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.”

KKK-ja është e organizuar në shtatë fusha kurrikulare, tri prej të cilave në mënyrë eksplicite trajtojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe nevojën për edukimin për zhvillim të qëndrueshëm. Fusha kurrikulare “Shkencat natyrore” u ofron nxënësve mundësi që të zhvillojnë të kuptuarit e koncepteve, teorive, ligjshmërive dhe dukurive themelore të natyrës. Ato kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, ndihmojnë në ngritjen e nivelit teknologjik dhe të zhvillimit ekonomik, rritjen e cilësisë së jetës së njeriut, si dhe në ruajtjen e shëndetit, mjedisit jetësor dhe mirëqenies. Shkencat natyrore nxënësve u mundësojnë të zhvillojnë kureshtjen për hulumtim shkencor të mjedisit natyror dhe të ndryshimeve të shkaktuara nga njeriu.

Fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi” kontribuon në të nxënësit për të jetuar së bashku si dhe në edukimin për zhvillim të qëndrueshëm. Fusha kurrikulare “Jeta dhe puna” ofron aktivitete sfiduese, të cilat përfshijnë hulumtimin, zgjidhjen e problemeve, shqyrtimin e koncepteve dhe të nxënësit që rezultojnë nga krijimi i produkteve me zbatim praktik. Nxënësit do të zhvillojnë kreativitetin e tyre dhe shkathtësi ndërmarrëse dhe do të inkurajohen për të qenë dizajnerë inovativë dhe kreativë të së ardhmes. Këto attribute janë thelbësore, pasi në të ardhmen nxënësit do të luajnë rol të madh duke përqafuar zhvillimet tekniko-teknologjike të shekullit XXI konform parimeve mjedisore, sociale dhe ekonomike. Kjo fushë kurrikulare përfshin: Shkathtësitë për jetë, Punëdore, Ekonomia shtëpiake, Këshillimi dhe orientimi në karrierë, Teknologjia dhe TIK-u, Edukimi për punë në profesion dhe ndërmarrësi, dhe Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

Janë zbatuar shumica e objektivave të parapara në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021 dhe brenda dokumentit është paraparë përfshirja e institucioneve akademike dhe hulumtuese në zbatimin e strategjive zhvillimore të vendit. Gjatë vitit 2020 do të publikohet Raporti Vlerësues për Zbatimin e PSAK-ut për tre vitet e kaluara, ku mund të gjinden në detaje përqindjet e zbatimit të objektivave të PSAK-ut, por edhe ngecjet. Poashtu planifikohet që gjatë vitit 2020 të themelohen grupet punuese për hartimin e dokumentit tjetër strategjik pesë-vjeçar të PSAK-ut 2022-2027.⁵⁸



56. Korniza Kurrikulare e Kosovës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës Burimi: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>. Qasur me 21.03.2020

57. Kompetencë në kuptimin e kësaj kurrikule është “aftësi të gjera për t’i zbatuar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, rutinat, vlerat dhe emocionet në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse”.

58. Intervista me përfaqësuesin e MASHT

8.3

Shkenca e qëndrueshmërisë

Zhvillimit të qëndrueshem nuk i është dhënë pozicioni qendror dhe nuk ka qenë në mesin e prioritetëve të para në procesin e hartimit të programeve. Kosova nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshem pa energji e sidomos energji elektrike. Andaj, zhvillimin e qëndrueshem duhet ta bazojë në energjinë elektrike të prodhuar nga burimet konvencionale dhe, në një përqindje të caktuar, edhe nga burimet e ripërtëritshme si uji, era dhe dielli.⁵⁹ Megjithatë, zhvillimi i qëndrueshem ka filluar të jetë komponentë e vlerësuar e strukturës së tërësishme të studimeve. Aktualisht, FIEK-u ofron programe të modifikuara në sensin e zbatimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në të gjitha sistemet bashkëkohore, në sistemet elektronike, robotikë, procese të automatizimit dhe në fushën e sistemeve elektroenergjetike. Kjo e fundit paraqet shtyllën qendrore për zhvillim të qëndrueshem të vendit dhe e njëta ka qenë subjekt trajtimi edhe në dy projekte të mëdha ndërkombëtare, me theks të ndarë në zhvillimet e përmbajtjeve programore dhe kurseve për burime të ripërtëritshme dhe zhvillim të qëndrueshem. Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) janë futur në programe studimore lëndë specifike që kanë të bëjnë me energjinë e ripërtëritshme. Për të ardhmen, kriteri i zhvillimit të qëndrueshem duhet të jetë pjesë e kërkesave strikte të dokumenteve në të cilat mbështetet hartimi i programeve të reja studimore (UA-15/2018 dhe politika të tjera).⁶⁰

Në nivelin Master, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) ofron një profil studimi me emrin Sistemet e Energjise së Ripërtëritshme. Ekziston gjithashtu qasja strategjike për një “qendër të ekspertizës teknike në sektorin e ujërave” që mbështet të gjitha institucionet e nën-sektorëve për adresimin e këtyre sfidave në menaxhimin e ujërave. Kjo qasje është zhvilluar konceptualisht për Institutin e Ujërave⁶¹ dhe vëmendje gjithashtu i është kushtuar nevojës për zhvillim akademik për të mbështetur argumentin e ekspertizës teknike në këtë sektor për vitet në vijim.⁶²

Në Departamentin e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor pranë Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA) të UP-së, komponenta e qëndrueshmërisë dhe koncepteve zhvillimore në harmoni me natyrën dhe shoqërinë është prezente në të gjitha lëndet. Gjatë viteve 2003-2005, FNA bashkë me Universitetin e Alborgut dhe Shkollën Mbretërore për Art dhe Arkitekturë në Kopenhage-Danimarkë, me mbështetje të programit të UN-Habitatit në Kosovë, ka hartuar programin Master për Planifikim dhe Menaxhim Urban, bazuar në dinamikën e reja globale-lokale, Agjendën Lolake 21, MDG dhe Kartën për Qeverisje të Mirë. Ky program nuk ka arritur të hyjë në funksion për dy arsye: e para, nuk kishte doktorantë të mjaftueshëm në FNA që do ta udhëhiqnin programin dhe e dyta, nuk pati edhe shumë vullnet që të krijohen ura bashkëpunimi dhe përmes moduleve të caktuara të rekrutohen për gjeneratën e parë profesore nga universitetet e jashtme.⁶³

59. Intervista me Prof. dr. Vjollca Komoni, FIEK

60. Intervista me Dekanin e FIEK Prof. dr. Enver Hamiti

61. I paqarte statusi dhe ekzistenca e këtij Instituti.

62. Intervista me Prof. dr. Naser Sahitin, FIM

63. Intervista me Prof. Eliza Hoxha, FNA-UP

Në vitin 2018, UP-ja në bashkëpunim me Arizona State University të SHBA-së themeloi Qendrën për Energji dhe Qëndrueshmëri (QEQ), e cila ofron programin certifikues “Energjia e Ripërtëritshme dhe Qëndrueshmëria”, ndërsa momentalisht jemi duke e realizuar një projekt me Ambasadën e SHBA-së në Prishtinë që ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe akademike të QEQ-it. Kështu UP-ja është duke ofruar mundësinë që të përgatiten kuadro të cilat do të nevojiten në tregun e punës në dekadat e ardhshme që do të karakterizohen me aktivitete të shumta në këtë fushë, në kuadër të përpjekjeve mbarëkombëtare drejt shoqërisë me pak ose pa karbon deri në vitin 2050.⁶⁴

Fakulteti i Shkencave Jetësore dhe Mjedisit (FShJM) në Universitetin e Prizrenit e ka të përfshirë zhvillimin e qëndrueshem. Në programin e Pyjeve dhe Mjedisit mund të përmendet menaxhimi i qëndrueshem i pyjeve, shfrytëzimi i pyjeve me një silvikulturë të qëndrueshme dhe ruajtja e reurseve natyrore, ndërsa në lëndën e Meteorologjisë fokusi është te ndryshimet klimatike në Kosovë dhe rreziqet që sjellin ato në mjedis, ekonomi, etj. Në programin Agrobiznes trajtohet menaxhim i qëndrueshem i ekonomisë bujqësore dhe zhvillimit rural, se si popullsia rurale duhet të kultivojë produktet bujqësore duke mos e dëmtuar tokën dhe të ketë qëndrueshmeri për të ardhmen. Po ashtu në menaxhimin e qëndrueshem të Agroturizmit, parashihet shfrytëzimi turistik i zonës rurale duke e ruajtur trashëgiminë dhe metodat e turizmit dhe duke ua përcjell gjeneratave të ardhshme, etj.

Në Fakultetin e Edukimit, me mbështetjen e programit Fulbright të qeverisë së SHBA-së është zhvilluar dhe futur në kurrikulën arsimore kursi “Edukimi për zhvillim të qëndrueshem”. Ky kurs synon të edukojë dhe të aftësojë mësimdhënësit e ardhshëm lidhur me

64. Intervista me drejtorin e QEQ Prof. dr. Naser Sahiti

parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe se si ata t'i përkthejnë këto parime në kërkesat e kurrikulës kombëtare për edukimin për zhvillim të qëndrueshëm si çështje ndërkurrikulare.

Projektet në fushën e qëndrueshmërisë dhe shkencës së qëndrueshmërisë janë të pakta. Projekti "Transformational Leadership Project - TLP" u zhvillua në partneritet mes UP-së dhe Arizona State University përmes të cilit janë zhvilluar një mori aktivitete në përputhje me objektivat që ka pasur. Projekti është fokusuar në tri komponente: zhvillimi dhe avancimi i mëtejme i plan-programit mësimor në fushën e energjisë, me fokus të veçantë në energjinë nga burimet e ripërtëritshme, metodologjia e mësimdhënies dhe avancimi në fushën e hulumtimeve shkencore. Aktualisht, QEQ-i po zbaton një projekt të Ambasadës së SHBA-së në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve profesionale dhe akademike të QEQ-it.⁶⁵

Në vitin 2019, FNA-ja ka realizuar një projekt të vogël pilot se bashku me Komunën e Prishtinës dhe UN-Habitat lidhur me komponenten gjinore në qytet nën konceptin "The Right To the City 4 All" (E drejta për qytet për të gjithë). Lokacioni i përzgjedhur i projektit ishte parku i qytetit, me qëllim për ta kuptuar nga afër rëndësinë e planifikimit gjithpërfshirës, sigurisë dhe mundësive të barabarta në qytet. Brengosëse është që UNDP-ja dhe organizata të tjera që i promovojnë Objektivat Zhvillimore të Mileniumit MDG dhe politikat nga niveli global në Kosovë duhet të lidhen me shume me institucionet akademike dhe të edukimit dhe të krijojnë ura bashkëpunimi e promovimi.⁶⁶

FSHJM-ja, edhe pse ka të nënshkuara disa memorandume bashkëpunimi me ndërmarrje dhe biznese, nuk ka pasur akoma projekte hulumtimi lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm. "Do ishte me interes dhe për Fakultetin përfshirja në projekte të ndryshme të një natyre të tillë, sepse është një fakultet i ri dhe unik për Kosovën, me një staf mjaft të kualifikuar, me hulumtime dhe studime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit".⁶⁷

9. Përfundimet

Kosova njihet si një nga vendet me më së shumti strategji dhe plane të veprimit të shkruara për një periudhë shtetësie prej 12 vjetësh. Zhvillimi i qëndrueshëm ka bazë kushtetuese dhe parimi i zhvillimit të qëndrueshëm në një masë më të madhe apo të vogël bën pjesë në dispozitat e ligjeve që trajtojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Nga këto ligje edhe derivojnë dokumentet strategjike për rregullimin e politikave zhvillimore ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke përfshirë ato të qeverisjes si shtylla e katërt e zhvillimit të qëndrueshëm.

Deri sot nuk ka dokument unik për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës. Asnjë nga dokumentet e analizuara në këtë hulumtim nuk e ka fjalën zhvillim i qëndrueshëm as në titullin e vet. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (SKZH) në ballinën e saj ka fjalën "Plan për zhvillim të qëndrueshëm" por nuk sqarohet se çka nënkupton kjo: a është moto e dokumentit apo diçka tjetër sepse nuk është se elaborohet më thellë në dokument. Ana teknike e shkrimit (gabimet gjuhësore, shkrimi akademik, estetika e tekstit tabelave dhe figurave) është pjesë përcjellëse e shumicës së dokumentave strategjike të analizuara e që në fakt nuk do të duhej të ndodhte.

Shumica e dokumentave të analizuara në përmbajtjen e tyre hapësirën më të madhe ua kushtojnë raporteve nga e kaluara, përshkrimit të gjendjes së trashëguar dhe shumë më pak merren me orientimet dhe planifikimet dhe zgjidhjet për të ardhmen. Kjo reflektohet edhe në përmbajtjen respektivisht volumin e tyre si p.sh. Strategjia për Zhvillimin e Pyjeve (SZHP) e që rregullon afër gjysmën e territorit të vendit ka gjithsej 34 faqe, ndërsa Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës (SSHUK) ka afër dhjetëfish më shumë (336 faqe). Të tjerat strategji dhe plane veprimi qëndrojnë ndërmjet këtyre dy shifrave. Edhe kur zgjidhjet përmenden ato janë të përgjithësuara, abstrakte dhe shpesh me formulime të mjegullta. Shumë pak ka masa me karakter obligativ si "duhet të..." dhe kryesisht gjenden në formën "do të...". Kjo në një formë edhe e eviton prezencën e matjes dhe indikatorëve të ndikimit të strategjive por edhe i liron institucionet zbatuese nga llogaridhënia mbi atë që kanë qenë të detyruara të arrijnë me strategjinë e caktuar. Indikatorët e matshëm për zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm mungojnë në shumicën e dokumenteve (ekzistojnë vetëm te SPKVNK-ja por bukur komplekse për t'u përcaktuar dhe matur). Mungojnë gjithashtu edhe institucionet bartëse dhe përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve sikurse mungojnë mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të shkallës së zbatimit të masave dhe aktiviteteve.

Përfshirja e politikave të qëndrueshme deri tani duket se është lidhur më shumë me politikat integruese të vendit në BE (përbushja e obligimeve ndërkombëtare dhe atyre integruese) dhe presionin nga shoqëria civile sesa nga një orientim serioz i institucioneve për të ndjekur rrugën e një zhvillimi të qëndrueshëm të vendit.

65. Naser Sahiti, QEQ-UP

66. Eliza Hoxha, FNA-UP

67. Intervista me përfaqësuesin e FSHJM, Universiteti i Prizrenit

Shumë pak ka ndodhur përfshirja e shkencës dhe hulumtimit nëpër dokumentet strategjike të hulumtuara. Edhe pse parimi i “zhvillimit të qëndrueshëm” është i shkruar brenda shumë ligjeve, politikave, standardeve dhe agjendave të ndryshme, është koha që këto parime të përkthehen në veprime konkrete dhe të reflektohen në menaxhimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Zhvillimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm janë me rëndësi kryesore për një të ardhme të mirë dhe një gjë e tillë kërkon vëmendje më të madhe në mënyrë që të ketë rezultate konkrete.

Akademia është përfshirë në procesin e zhvillimit të dokumenteve strategjike, mirëpo përfshirja e Universitetit është parë si vetëm simbolike për arsye të mungesës së kompensimeve adekuate. Në pothuajse të gjitha institucionet është paraparë angazhimi i institucioneve hulumtuese dhe akademisë për dokumentet e tyre strategjike. Të gjitha institucionet pohojnë se janë zbatuar disa nga masat dhe aktivitetet e planifikuara në dokumentet strategjike. MASHT-i dhe MZHEA-ja kanë ngritur shqetësime lidhur me aspektin zbatues dhe/ose financiar, dhe raportojnë probleme mes akterëve përgjegjës në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm. Institucionet pohojnë se kanë dokumente strategjike për të ardhmen e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Universitetet prodhojnë dijen, por shihet se në Kosovë ende nuk janë akterë në proceset e zhvillimit të qëndrueshëm. Disa nga universitetet kanë zhvilluar programe kurrikulare që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe shkencën e qëndrueshmërisë, por projekte konkrete për zhvillim të qëndrueshëm ka shumë pak. Zhvillimi më pozitiv në fushën e politikave kurrikulare mund të konsiderohet futja e edukimit për qëndrueshmëri në Kornizën Kurrikulare të Kosovës si çështje ndërkurrikulare. Kjo nënkupton që fëmijët e sistemit arsimor parauniversitar do të mësojnë për çështjet e qëndrueshmërisë përgjatë të gjitha shkallëve kurrikulare dhe klasave në rrafshin vertikal dhe në të gjitha fushat kurrikulare dhe lëndët shkollore në rrafshin horizontal.

10. Shtojcat

SHTOJCA 1. DOKUMENTAT E ELABORUARA NË HULUMTIM

Dokumenti	Nr. i faqeve	Sponzor
Strategjia Shtetërore e Ujërave	336	Kuvendi i RKS-së, Qeveria e RKS-së , ZKM-Këshilli ndër-ministrot për ujëra; MMPH; MZHE, MBPZHR; MF, Komunitat e Kosovës
Plani Hapësinor i Kosovës	192	Qeveria e RKS-së, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Instituti për Planifikim Hapësinor
Strategjia Energjetike e Republikës së Kosovës	118	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës	46	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Strategjia Kombëtare për Zhvillim	56	Qeveria e Kosovës - Zyra e Kryeministrit
Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit	60	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike	92	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal	44	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Strategjia për Vetëqeverisjen Lokale	221	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	61	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë	34	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Korniza Kurrikulare e Kosovës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës	78	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

INSTITUCIONET QEVERITARE:

Fadil Q. Bajraktari - Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ambientit

Ferit Idrizi - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Hazbije Kastrati - Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Sabit Restelica - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Rozafa Ukimeraj Quni - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Tahir Ahmeti - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE:

Afete Musliu - Edukimi Mjedisor (nuk ka kthyer përgjigje)

Arben Nika, Tahir Krasniqi - Center for Education and Development of Environment (CEDE) - (nuk kane kthyer përgjigje)

Bardh Sanaja, Fatos Lajqi - Environmentally Responsible Action Group (ERA) - (nuk kanë kthyer përgjigje)

Dardan Abazi - Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Xhevdet Gegolla - Fondacioni Jeshil.

INSTITUCIONET AKADEMIKE:

Eliza Hoxha - Fakulteti i Arkitekturës - Universiteti i Prishtinës

Enver Hamiti - Fakulteti i Inxhinierise Elektrike dhe Kompjuterike - Universiteti i Prishtinës;

Ilir Morina - Fakulteti i Agrobiznesit - Universiteti i Pejës (nuk ka kthyer përgjigje)

Naser Sahiti - Fakulteti i Inxhinierise Mekanike, Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri - Universiteti i Prishtinës

Vjollca Komoni - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike - Universiteti i Prishtinës

Ylli Kortoci - Fakulteti i Shencave të Jetës dhe Mjedisit - Universiteti Prizrenit

